REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

RELACION DHE STUDIM PËR RISHIKIMIN E NUMRIT TË GJYQTARËVE NË SISTEMIN GJYQËSOR SHQIPTAR

Analizë e kapaciteteve 2023–2025 dhe propozim për periudhën 2026–2030

Treguesi kryesor	Vlera e propozuar
Shtesa operacionale e përhershme në shkallën e parë dhe apel	84 gjyqtarë
Rezerva funksionale e përhershme	18 gjyqtarë
Shtesa e përhershme gjithsej	102 gjyqtarë
Organika kombëtare pas shtesës së përhershme	519 gjyqtarë
Shtesa e përkohshme në Gjykatën e Lartë për 1 mandat	9 gjyqtarë
Kapaciteti maksimal gjatë mandatit të posaçëm	528 gjyqtarë
Personeli jogjyqtar për 102 vendet	minimum 336
Personeli jogjyqtar i përkohshëm për 9 gjyqtarë	56 punonjës

Tiranë 2026

Përmbledhje ekzekutive

Ky relacion i paraqitet Këshillit të Lartë Gjyqësor për të mbështetur vendimmarrjen mbi rishikimin e numrit të gjyqtarëve dhe mbi burimet njerëzore që duhet të shoqërojnë këtë rritje. Analiza bashkon të dhënat e personelit, fluksin e çështjeve, stokun, produktivitetin, treguesit e CEPEJ dhe krahasimin demografik. Përfundimi është se sistemi nuk mund të stabilizohet vetëm me plotësimin e vakancave të organikës aktuale. Krahas plotësimit të tyre, kërkohet rritje strukturore në shkallën e parë dhe apel, si dhe një masë e posaçme e kufizuar në kohë për Gjykatën e Lartë.

Të dhënat e datës 24.09.2026, paraqesin 417 vende të miratuara, 343 gjyqtarë në organikën faktike dhe 309 gjyqtarë efektivisht në detyrë. Hendeku 108 është diferenca ndërmjet strukturës dhe kapacitetit efektiv dhe nuk përfaqëson 108 vakanca të përhershme. Ky hendek trajtohet me plan të veçantë dhe nuk përfshihet në 102 vendet e reja të këtij propozimi.

Shtesa e përhershme prej 102 vendesh ka dy shtresa të ndara. Shtresa e parë përmban 84 vende operacionale, të lidhura me fluksin, stokun, aftësinë e gjykatave për të formuar trupa dhe nevojën për kapacitet të qëndrueshëm dhe ndahet në 64 vende në shkallën e parë dhe 20 vende në apel. Shtresa e dytë përmban 18 vende të rezervës funksionale, 10 për shkallën e parë dhe 8 për apelin, për të kompensuar humbjen afatgjatë të FTE-së[1] kur gjyqtarë me status aktiv shërbejnë si anëtarë të KLGJ-së, këshilltarë në Gjykatën e Lartë, pranë ILD-së ose në institucione të tjera të sistemit të drejtësisë. Si rezultat, organika kombëtare rritet nga 417 në 519 gjyqtarë.

Rivlerësimi i mbështetur në Raportin Vjetor të KLGJ-së 2025 i ndan 44 vendet e juridiksionit të përgjithshëm të shkallës së parë në 26 vende jashtë Tiranës dhe 18 vende në Tiranë. Jashtë Tiranës propozohen, Durrës 6, Elbasan 5, Fier 6, Korçë 3, Shkodër 3 dhe Vlorë 3. Gjykatat e tjera ruajnë organikën ekzistuese dhe përfitojnë nga plotësimi i vakancave dhe rezerva funksionale, por nuk marrin vend të ri operacional në fazën e parë. Pjesa tjetër e paketës 84 mbetet, 18 vende në gjykatat administrative të shkallës së parë, 2 në gjykatën e posaçme të shkallës së parë, 6 në Apelin e Juridiksionit të Përgjithshëm, 12 në Apelin Administrativ dhe 2 në Apelin e Posaçëm.

Për Gjykatën e Lartë propozohet që KLGJ të miratojë nevojën për një kapacitet shtesë prej 9 gjyqtarësh për një mandat të vetëm, të parinovueshëm dhe të lidhur me një portofol të përcaktuar çështjesh. Aktivizimi i kësaj mase nuk mund të bëhet vetëm me një vendim organizativ. Ai kërkon kontroll kushtetues dhe ligjor, si dhe krijimin e bazës së nevojshme normative. Nëse emërimi i gjyqtarëve të përkohshëm nuk lejohet, duhet të zgjidhet një mekanizëm ligjor ekuivalent që prodhon të njëjtin kapacitet pa cenuar përbërjen, procedurën e emërimit dhe mandatin e anëtarëve të Gjykatës së Lartë.

Rritja e numrit të gjyqtarëve duhet të shoqërohet me administratë gjyqësore dhe personel teknik. Raportet faktike të CEPEJ për Shqipërinë në vitin 2024 është 2,9 punonjës për gjyqtar në shkallën e parë, 4,3 në apel dhe 6,2 në Gjykatën e Lartë, të cilët japin një dysheme planifikimi prej 336 punonjësish të përhershëm për 102 vendet dhe 56 punonjësish për paketën e përkohshme 9. Raporti Vjetor i KLGJ-së 2025 referon ndërkohë mesataren europiane 4,12 dhe raportin strukturor shqiptar 3,13. Aplikimi i 4,12 vetëm si kontroll konvergence mbi 102 vendet jep 421 punonjës. Për rrjedhojë rekomandohet minimumi 336, me analizë të vendeve të punës që mund ta çojë tavanin deri në 421. Asnjëra shifër nuk duhet zbatuar mekanikisht pa organikë sipas gjykatës.

[1] **FTE (Full-Time Equivalent)** është njësia matëse e kapacitetit real të punës, ku 1 FTE përfaqëson një punonjës që ushtron detyrën me kohë të plotë gjatë gjithë periudhës së referencës, ndërsa angazhimet me kohë të pjesshme ose mungesat afatgjata llogariten proporcionalisht.

Skenari	Gjyqtarë	Ndryshimi ndaj 417	Ndryshimi ndaj 309	Për 100 000 banorë
Gjendja efektive	309	-108	-	13,2
Organika aktuale	417	-	+108	17,9
Pas 84 vendeve operacionale	501	+84	+192	21,4
Pas 84 + 18 vendeve të përhershme	519	+102	+210	22,2
Gjatë mandatit të posaçëm +9	528	+111	+219	22,6
Mesatarja europiane CEPEJ 2022	514	+97	+205	22,0

Vendimmarrja e propozuar

1. Miratimi i 84 vendeve të reja operacionale të përhershme në shkallën e parë dhe apel, të ndara në 64 vende për shkallën e parë dhe 20 vende për apelin.
2. Miratimi, veçmas dhe mbi paketën 84, i 18 vendeve të përhershme të rezervës funksionale, të ndara fillimisht në 10 vende për shkallën e parë dhe 8 vende për apelin.
3. Mbyllja paralele e hendekut efektiv 108.
4. Miratimi i nevojës për një kapacitet të përkohshëm prej 9 gjyqtarësh në Gjykatën e Lartë për një mandat të vetëm dhe nisja e procedurës për vlerësimin kushtetues dhe ligjor të mekanizmit.
5. Miratimi i 336 punonjësve jogjyqtarë si minimum planifikimi për 102 vendet e përhershme, i 56 punonjësve për paketën e përkohshme dhe i analizës së vendeve të punës për një tavan deri në 421 vende të përhershme.
6. Rishikimi vjetor i shpërndarjes së vendeve sipas FTE-së reale, fluksit, Clearance Rate, Disposition Time, moshës së stokut dhe peshës së çështjeve.

Përmbajtja

1. Qëllimi, objekti dhe vendimi që kërkohet 5
2. Kuadri ligjor dhe institucional 5
3. Burimet e të dhënave, cilësia dhe kufizimet 6
4. Kuadri metodologjik i CEPEJ 7
5. Gjendja aktuale e kapaciteteve gjyqësore 8
6. Krahasimi demografik europian 10
7. Metodologjia e llogaritjes 11
8. Rezultatet për gjykatat e shkallës së parë 12
9. Rezultatet për apelin, gjykatat e posaçme dhe Gjykatën e Lartë 17
10. Arsyetimi i plotë i vendimmarrjes së propozuar 19
11. Administrata gjyqësore dhe personeli mbështetës 25
12. Plani i zbatimit dhe ndikimi buxhetor 27
13. Monitorimi dhe rishikimi vjetor 30
14. Rreziqet dhe masat kontrolluese 30
15. Përfundimet dhe formulimi i vendimmarrjes 32
Shtojcat dhe burimet 33

1. Qëllimi, objekti dhe vendimi që kërkohet

Objekti i këtij relacioni është përcaktimi i numrit të gjyqtarëve që nevojitet për funksionimin normal të gjykatave, për ndalimin e krijimit të stokut të ri dhe për uljen e stokut të akumuluar. Dokumenti vlerëson njëkohësisht numrin e vendeve të miratuara, kapacitetin real në detyrë dhe numrin që kërkohet nga ngarkesa. Organika tregon kufirin e miratuar dhe numri efektiv tregon sa kapacitet është realisht i disponueshëm si dhe nevoja nga ngarkesa tregon sa kapacitet duhet për të përballuar punën.

Vendimi që i kërkohet KLGJ-së ka tri pjesë të lidhura, por juridikisht të dallueshme. Pjesa e parë është rritja e përhershme operacionale me 84 vende në shkallën e parë dhe apel. Pjesa e dytë është krijimi, mbi këtë shtesë, i 18 vendeve të përhershme të rezervës funksionale. Këto dy pjesë japin 102 vende të reja të përhershme dhe e çojnë organikën kombëtare nga 417 në 519. Pjesa e tretë është e kufizuar në kohë dhe konsiston në njohjen e nevojës për 9 gjyqtarë shtesë në Gjykatën e Lartë për një mandat të vetëm. Pjesa e tretë kërkon ndërhyrje normative ose një mekanizëm tjetër të lejuar nga Kushtetuta dhe ligji dhe për rrjedhojë, miratimi i nevojës nuk duhet të ngatërrohet me emërimin e menjëhershëm.

Periudha e planifikimit është 2026-2030. Kjo periudhë lejon që rritja të lidhet me ciklin buxhetor, kapacitetet e Shkollës së Magjistraturës, procedurat e emërimit dhe ngritjes në detyrë, si dhe me objektivin e uljes së stokut. Rritja duhet të zbatohet me faza, sepse krijimi formal i vendeve pa burim rekrutimi, pa personel mbështetës dhe pa infrastrukturë do të shtonte organikën në letër, por jo kapacitetin gjykues.

Relacioni propozon një shpërndarje fillestare të 84 vendeve operacionale sipas gjykatave dhe juridiksioneve, por nuk e trajton atë si të pandryshueshme. Aneksi përfundimtar do të rakordojë të dhënat individuale të personelit, FTE-në reale, moshën e stokut dhe gatishmërinë infrastrukturore para aktivizimit të shtesës. Për 18 vendet e rezervës funksionale përcaktohet vetëm ndarja sipas nivelit, sepse destinacioni konkret duhet të ndjekë gjykatën që humbet FTE nga një angazhim institucional i dokumentuar.

Në kuptimin e këtij dokumenti, FTE reale është ekuivalenti me kohë të plotë i kapacitetit gjykues faktik. Një gjyqtar që ushtron funksionin gjatë gjithë vitit llogaritet 1 FTE dhe një gjyqtar i disponueshëm vetëm për gjysmën e vitit llogaritet 0,5 FTE, ndërsa gjyqtari që gjatë gjithë periudhës ushtron një detyrë jashtë gjykatës llogaritet 0 FTE për gjykatën e origjinës. Përdorimi i FTE-së shmang mbivlerësimin që krijon numërimi formal i personave pa marrë parasysh kohën reale të gjykimit.

2. Kuadri ligjor dhe institucional

Rishikimi i numrit të gjyqtarëve lidhet me përgjegjësinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor për administrimin dhe funksionimin e sistemit gjyqësor. Vlerësimi duhet të respektojë Kushtetutën, ligjin nr. 115/2016 për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë, ligjin nr. 98/2016 për organizimin e pushtetit gjyqësor dhe ligjin nr. 96/2016 për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, të gjitha të ndryshuara. Këto akte përcaktojnë kompetencat institucionale, organizimin e gjykatave, statusin e magjistratëve dhe garancitë e pavarësisë.

Vendimi për rritjen e organikës duhet të mbështetet në të dhëna të verifikueshme dhe të shpjegojë lidhjen ndërmjet numrit të propozuar dhe nevojës së shërbimit. Ngarkesa e punës është baza kryesore, por jo e vetmja. Duhet të merren parasysh përbërja minimale e trupave, specializimi, zëvendësimi i gjyqtarëve, drejtimi i gjykatës, aksesi territorial, kohëzgjatja e çështjeve dhe roli i personelit mbështetës. Për këtë arsye, formula matematikore jep pikën e nisjes, ndërsa vendimi përfundimtar mbetet një vlerësim institucional i arsyetuar.

Rezerva funksionale prej 18 vendesh duhet të ndërtohet në mënyrë që të mos cenojë palëvizshmërinë dhe statusin e gjyqtarit. Ajo nuk është një listë gjyqtarësh që mund të lëvizen pa kriter. Është një kapacitet kombëtar i autorizuar, i cili shpërndahet ose rishpërndahet me vendim të arsyetuar, në përputhje me ligjin, kur një gjykatë humbet përkohësisht FTE për shkak të një funksioni institucional të gjyqtarit. Kthimi i gjyqtarit në gjykatë nuk duhet të krijojë pasiguri statusi për

gjyqtarin e emëruar në vendin e ri dhe për këtë arsye, vendi rezervë duhet të jetë i përhershëm dhe rishpërndarja të bëhet vetëm me instrumente të ligjshme.

Propozimi për 9 gjyqtarë të përkohshëm në Gjykatën e Lartë kërkon kujdes më të madh. Përbërja dhe mandati i anëtarëve të kësaj gjykate mbrohen nga kuadri kushtetues dhe ligjor. KLGJ mund të evidentojë nevojën funksionale, të miratojë analizën e ngarkesës dhe të propozojë ndërhyrjen e nevojshme normative, por nuk duhet të krijojë me akt administrativ një kategori gjyqtari që ligji duhet riparë. Dokumenti, për këtë arsye, e trajton paketën 9 si nevojë të vlerësuar dhe si mandat për përgatitjen e zgjidhjes juridike, jo si bazë të drejtpërdrejtë emërimi.

Rritja e numrit të gjyqtarëve sjell detyrimin për të rishikuar organikën e administratës gjyqësore dhe programimin buxhetor. Një vend gjyqtari pa sekretari, mbështetje teknike dhe hapësirë pune nuk prodhon rendimentin e parashikuar. Vendimi duhet të miratojë paralelisht numrin orientues të personelit jogjyqtar dhe të ngarkojë strukturat përgjegjëse për përgatitjen e ndryshimeve të organikës dhe të kërkesave në programin buxhetor afatmesëm.

3. Burimet e të dhënave, cilësia dhe kufizimet

3.1 Burimet kombëtare

Analiza përdor pasqyrat e numrit të gjyqtarëve, të dhënat e çështjeve për vitet 2021-2025, modelet e punës për gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm dhe administrative, shpjegimet metodologjike të vëna në dispozicion dhe Raportin Vjetor të KLGJ-së 2025. Për standardin minimal sasior janë përdorur vlerat 400 çështje në vit për gjyqtar në juridiksionin e përgjithshëm të shkallës së parë dhe 350 çështje në vit për gjyqtar në shkallën e parë administrative, në referim të vendimit nr. 433, datë 22.07.2025 të KLGJ-së.

Pasqyra e përditësuar e personelit e datës 24.09.2026 jep 417 vende të miratuara, 343 gjyqtarë në organikën faktike dhe 309 gjyqtarë efektivisht në detyrë. Këto shifra përdoren për fotografinë vendimmarrëse. Raporti Vjetor i KLGJ-së paraqet fotografinë historike të datës 31.12.2025, 417 vende, 344 gjyqtarë në fakt dhe 306 efektivë. Modelet e ngarkesës përdorin mesatare FTE për periudhën 2023-2025 dhe, për këtë arsye, nuk duhet të pritet që shuma e FTE-ve në tabelat e llogaritjes të jetë identike me gjendjen e personelit në një datë të vetme.

3.2 Burimet ndërkombëtare dhe demografike

Parimet e metodologjisë dhe krahasimi europian mbështeten në Raportin e Vlerësimit të CEPEJ 2024 me të dhëna të vitit 2022, Profilin e Shqipërisë në Dashboard Western Balkans II me të dhëna të vitit 2024, mjetin e CEPEJ për Reduktimin e Backlog-ut, studimin e CEPEJ për peshimin e çështjeve dhe studimin e vitit 2025 për sistemet e matjes së ngarkesës. Për popullsinë përdoret vlera 2 335 930 banorë më 1 janar 2026, publikuar nga INSTAT.

Për personelin jogjyqtar përdoret profili i CEPEJ për Shqipërinë me të dhëna të vitit 2024. Ai raporton 1 084 punonjës jogjyqtarë dhe një raport të përgjithshëm 3,3 punonjës për gjyqtar. Raporti ndryshon sipas nivelit, 2,9 në shkallën e parë, 4,3 në shkallën e dytë dhe 6,2 në Gjykatën e Lartë. Këto raporte përdoren për planifikimin e shtesës, por jo si normë automatike për çdo gjykatë.

3.3 Rakordimi dhe kufizimet

- Të dhënat kanë data reference të ndryshme. Gjendja aktuale e personelit është fotografi në një datë, ndërsa produktiviteti dhe FTE-ja janë mesatare vjetore.
- Raporti Vjetor 2025 dhe materiali i datës 24.09.2026 nuk zëvendësojnë njëri-tjetrin. I pari mat fundin e vitit 2025, ndërsa i dyti gjendjen më të afërt me vendimmarrjen.
- Modelet e detajuara sipas standardit të KLGJ-së janë të plota për gjykatat e shkallës së parë. Për apelin dhe Gjykatën e Lartë përdoret produktiviteti faktik si tregues planifikimi.
- Stoku total nuk është automatikisht backlog. Për masën e rikuperimit duhet të përdoret pjesa e stokut që ka kaluar afatin standard ose objektivin kohor të përcaktuar.

- Materialet nuk përmbajnë një regjistër nominal të plotë të gjyqtarëve që do të ushtrojnë funksione jashtë gjykatës. Numri 18 është tavan planifikimi dhe duhet të verifikohet përmes regjistrit nominal dhe vit pas viti.
- Raportet e personelit jogjyqtar të CEPEJ pasqyrojnë strukturën e vitit 2024. Shpërndarja përfundimtare kërkon analizë të roleve, proceseve dhe teknologjisë në secilën gjykatë, e cila bëhet pas miratimit të numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve.

Këto kufizime nuk e bëjnë analizën të papërdorshme. Ato përcaktojnë se cilat pjesë mund të miratohen si numër kombëtar dhe cilat duhet të plotësohen me aneks teknik. Të dhënat mbështesin miratimin e 84 vendeve operacionale si tavan shumëvjeçar, të 18 vendeve të veçanta të rezervës funksionale, të masës së përkohshme 9 dhe të personelit mbështetës. Megjithatë, shpërndarja e çdo pozicioni duhet të verifikohet çdo vit, sepse CEPEJ nuk përcakton një numër normativ gjyqtarësh për popullsi dhe modelet sasiore nuk zëvendësojnë analizën e kompleksitetit.

4. Kuadri metodologjik i CEPEJ

4.1 Clearance Rate dhe Disposition Time

Clearance Rate mat aftësinë e gjykatës për të përballuar fluksin e ri. Ai llogaritet duke pjesëtuar çështjet e përfunduara me çështjet e ardhura gjatë së njëjtës periudhë dhe duke shumëzuar me 100. Vlera 100 për qind tregon ekuilibër. Vlera nën 100 për qind tregon se hyjnë më shumë çështje sesa përfundojnë dhe se stoku rritet. Gjatë fazës së rikuperimit, objektivi duhet të jetë mbi 100 për qind për një periudhë të qëndrueshme, sepse vetëm kështu ulet stoku krahas përballimit të hyrjeve të reja.

Disposition Time është një vlerësim teorik i kohës së nevojshme për të përpunuar stokun me ritmin aktual. Ai llogaritet duke pjesëtuar çështjet në pritje me çështjet e përfunduara dhe duke shumëzuar rezultatin me 365 ditë. Treguesi nuk parashikon kohëzgjatjen e një çështjeje konkrete, por lejon krahasimin ndërmjet viteve dhe gjykatave. Një DT i lartë, i shoqëruar me CR nën 100 për qind, tregon nevojë të fortë për ndërhyrje në kapacitet ose në organizimin e punës.

4.2 Backlog dhe mosha e stokut

CEPEJ e dallon stokun nga backlog-u. Stoku përfshin të gjitha çështjet e papërfunduara në një datë të caktuar. Backlog-u përfshin çështjet që nuk janë përfunduar brenda afatit ose objektivit kohor të përcaktuar. Ky dallim është i rëndësishëm sepse përdorimi i të gjithë stokut në formulën e rikuperimit mund të mbivlerësojë numrin e gjyqtarëve, ndërsa përjashtimi i çështjeve të vjetra do ta nënvlerësonte problemin.

Mosha e çështjes nuk duhet të shumëzojë drejtpërdrejt formulën e personelit. Ajo përdoret për të përcaktuar cilat çështje hyjnë në stokun e rikuperimit dhe në çfarë rendi duhet të trajtohen. Raportimi duhet të ndajë së paku çështjet nën një vit, nga një deri në tre vjet, mbi tre vjet dhe mbi pesë vjet. Objektivat e paketës së re duhet të përfshijnë ulje të matshme të dy kategorive të fundit.

4.3 Caseload, workload dhe peshimi i çështjeve

Caseload-i numëron çështjet, workload-i mat përpjekjen që kërkohet për trajtimin e tyre. Dy gjykata me të njëjtin numër çështjesh mund të kenë ngarkesë të ndryshme nëse njëra trajton çështje më komplekse, trupa gjykues, prova voluminoze ose procedura me shumë palë. Për këtë arsye, numri i çështjeve është i domosdoshëm, por jo i mjaftueshëm për shpërndarjen përfundimtare të vendeve.

Peshimi i çështjeve cakton një vlerë relative sipas kohës dhe kompleksitetit. Deri në krijimin e një sistemi të plotë kombëtar, KLGJ mund të zbatojë një model të thjeshtuar me grupe çështjesh dhe kampionim të kohës së punës. Rezultati duhet të përdoret për rishikimin vjetor të 84 vendeve operacionale dhe për shpërndarjen e personelit mbështetës. Pa këtë korrigjim, gjykatat me çështje të vështira mund të duken artificialisht më pak produktive.

4.4 Raporti me popullsinë

Raporti i gjyqtarëve për 100 000 banorë është tregues krahasues dhe jo standard detyrues i CEPEJ-së. Ai nuk përcakton vetë organikën, sepse sistemet ndryshojnë në kompetenca, procedura, hartë gjyqësore dhe personel mbështetës. Në këtë studim raporti demografik përdoret pas llogaritjes nga ngarkesa, si kontroll i arsyeshmërisë së rezultatit kombëtar. Për këtë arsye, shprehja "mesatare europiane" nuk përdoret si kuotë automatike për Shqipërinë.

4.5 Personeli jogjyqtar

CEPEJ e trajton personelin jogjyqtar si pjesë të kapacitetit të gjykatës. Profili i Shqipërisë tregon se rritja e organikës së gjyqtarëve duhet të shoqërohet nga tri kategori mbështetjeje. Përqendrimi vetëm te ndihmësit ligjorë ose vetëm te sekretaria do të linte bosh procese të tjera të nevojshme për funksionimin e gjykatës.

5. Gjendja aktuale e kapaciteteve gjyqësore

Struktura e miratuar e sistemit përfshin 417 vende gjyqtari. Më 24.09.2026 organika në fakt është 343 dhe numri efektiv 309. Kështu, hendeku efektiv është 108. Ai duhet të quhet hendek kapaciteti dhe jo numër vakancash të përhershme, sepse bashkon dy dukuri juridikisht dhe menaxherialisht të ndryshme.

Niveli i gjykatës	Struktura	Organika në fakt	Efektivisht	Hendeku efektiv
Gjykata e Lartë	19	17	15	4
Apeli i juridiksionit të përgjithshëm	78	37	41	37
Apeli i posaçëm	11	10	10	1
Shkalla e parë e juridiksionit të përgjithshëm	235	216	180	55
Shkalla e parë e posaçme	16	13	15	1
Apeli administrativ	22	14	18	4
Shkalla e parë administrative	36	36	30	6
TOTALI	**417**	**343**	**309**	**108**

Në disa kategori numri efektiv mund të jetë më i lartë se organika në fakt. Kjo ndodh kur kapaciteti përforcohet me delegim, caktim të përkohshëm ose mekanizma të tjerë mobiliteti. Ky tejkalim nuk është organikë e qëndrueshme. Për planifikim duhet të përdoret FTE-ja vjetore dhe të identifikohet burimi i çdo gjyqtari të caktuar, në mënyrë që i njëjti person të mos numërohet si kapacitet i plotë në dy gjykata.

5.1 Rakordimi me të dhënat e datës 31.12.2025

Raporti Vjetor i KLGJ-së 2025 raporton 417 vende në strukturë, 344 gjyqtarë në fakt dhe 306 efektivisht në detyrë në fund të vitit 2025. Ai e ndan hendekun 111 në 73 vakanca të përhershme dhe 38 vakanca ose mungesa të përkohshme. Materiali i datës 24.09.2026 paraqet 417, 343 dhe 309, pra 74 vende të pazëna, 34 FTE neto të padisponueshme dhe hendek 108. Ndryshimi nuk është mospërputhje metodologjike, por lëvizje ndërmjet dy datave të raportimit.

Data	Struktura	Në fakt	Efektivisht	Hendeku permanent	Mungesa funksionale	Hendeku efektiv
31.12.2025	417	344	306	73	38	111
24.09.2026	417	343	309	74	34	108
Ndryshimi	**0**	**-1**	**3**	**1**	**-4**	**-3**

Për vendimin e ri përdoren të dhënat e datës 24.09.2026, sepse është më e afërt me datën e vendimmarrjes. Të dhënat e datës 31.12.2025 ruhet si pikë kontrolli për të parë dinamikën. Në raportimin vijues duhet të përdoret gjithmonë kjo strukturë, organikë në fakt dhe FTE efektive. Vetëm kështu mund të dallohet nëse përmirësimi vjen nga emërimi në një vend bosh, nga kthimi i një gjyqtari në gjykatë apo nga delegimi i përkohshëm nga një gjykatë tjetër.

5.2 Vakancat e zakonshme

Vakancë e zakonshme është vendi i miratuar që nuk është plotësuar me gjyqtar. Plotësimi vendeve të pazëna më 24.09.2026 nuk përbën rritje të organikës por realizon strukturën të miratuar tashmë. Plani i rekrutimit duhet t'i trajtojë këto vende paralelisht me 102 vendet e reja, sepse gjykata nuk përfiton nga rritja formale e organikës nëse vendet ekzistuese vazhdojnë të mbeten bosh.

5.3 Mungesat funksionale

Mungesa funksionale ekziston kur vendi është formalisht i zënë, por gjyqtari nuk ushtron funksion gjykues në gjykatën e origjinës për një periudhë të konsiderueshme. Shembujt përfshijnë anëtarësimin në KLGJ, shërbimin si këshilltar në Gjykatën e Lartë, angazhimin pranë ILD-së ose një funksion tjetër institucional të parashikuar nga ligji. Këto raste nuk shfaqen gjithmonë si vakanca, por ulin numrin e trupave që mund të gjykojnë.

Për këtë arsye, propozohen 18 vende të përhershme mbi paketën operacionale 84. Ato nuk janë pjesë e 84 vendeve dhe nuk aktivizohen mbi bazën e një vlerësimi të përgjithshëm. Për çdo rast duhet të ekzistojë regjistri nominal me gjykatën e origjinës, funksionin e ri, bazën ligjore, datën e fillimit, kohëzgjatjen dhe FTE-në që humbet gjykata. Ky regjistër është mekanizmi që parandalon numërimin e dyfishtë dhe që provon se rezerva po kompenson një mungesë reale.

6. Krahasimi demografik europian

Me popullsi 2 335 930 banorë më 1 janar 2026, kapaciteti efektiv prej 309 gjyqtarësh përfaqëson 13,2 gjyqtarë për 100 000 banorë dhe organika aktuale 417 përfaqëson 17,9. Pas 84 vendeve operacionale organika arrin 501 ose 21,4 për 100 000 banorë. Pas shtimit të veçantë të 18 vendeve të rezervës funksionale, organika e përhershme arrin 519 ose 22,2. Gjatë mandatit të 9 gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë, tavani i përkohshëm arrin 528 ose 22,6 për 100 000 banorë.

Raporti 22,0 i mesatares europiane të raportuar nga CEPEJ për të dhënat e vitit 2022 do të korrespondonte me rreth 514 gjyqtarë për popullsinë e Shqipërisë. Mediana e Bashkimit Europian 21,5, e përdorur si pikë reference në profilin e CEPEJ për Shqipërinë, do të korrespondonte me 503 gjyqtarë kur rezultati rrumbullakohet lart. Organika 519 është 5 vende mbi ekuivalentin e mesatares europiane, ndërsa tavani i përkohshëm 528 është 14 vende mbi të. Ky tejkalim shpjegohet nga rezerva funksionale dhe nga masa e kufizuar në kohë për stokun e Gjykatës së Lartë dhe nuk paraqitet si standard i përhershëm i nevojshëm për çdo vit.

Pika e krahasimit	Raporti për 100 000	Numri teorik për popullsinë 2026	Diferenca ndaj 417
Gjendja efektive kombëtare	13,2	309	-108
Organika aktuale kombëtare	17,9	417	-
Mediana e Këshillit të Europës 2022	17,6	412	-5
Mediana e Bashkimit Europian 2023	21,5	503	+86
Mesatarja europiane CEPEJ 2022	22,0	514	+97
Mesatarja e Ballkanit Perëndimor 2024	29,0	678	+261

Organika aktuale është pranë medianës së Këshillit të Europës, por kapaciteti efektiv mbetet dukshëm poshtë saj. Kjo tregon se plotësimi real i vendeve është kusht i parë. Organika 501, që rezulton vetëm nga 84 vendet operacionale, është

pranë medianës së Bashkimit Europian. Organika 519, pas rezervës funksionale, është pranë mesatares europiane 22,0. Krahasimi nuk prodhon shifrën 102, por vetëm kontrollon nëse rezultati i arsyetuar nga ngarkesa dhe nevoja institucionale mbetet në një interval të shpjegueshëm europian.

Në interpretimin e raportit duhet bërë një dallim i rëndësishëm. Të 18 vendet e rezervës funksionale nuk synojnë të rrisin në mënyrë të zakonshme volumin e gjykimit, por të zëvendësojnë FTE që mungon sepse gjyqtari me status aktiv shërben jashtë gjykatës. Prandaj raporti formal 22,2 për 100 000 banorë nuk është plotësisht i krahasueshëm me një sistem ku çdo gjyqtar i numëruar është i disponueshëm në gjykatë. Për monitorim duhet të publikohen paralelisht raporti i organikës dhe raporti i FTE-së reale.

Mesatarja e Ballkanit Perëndimor do të jepte 678 gjyqtarë për popullsinë e Shqipërisë. Ky rezultat nuk propozohet, sepse numri i gjyqtarëve në rajon ndikohet nga struktura institucionale dhe kompetencat e ndryshme. Raporti demografik nuk mund të zëvendësojë analizën e fluksit dhe të produktivitetit. Ai ndihmon vetëm për të shmangur një rezultat kombëtar dukshëm të ulët ose të lartë pa shpjegim.

7. Metodologjia e llogaritjes

7.1 Periudha e referencës

Periudha bazë është 2023-2025. Mesatarja trevjeçare ul ndikimin e luhatjeve të një viti, të ndryshimeve nga harta e re gjyqësore dhe të masave të përkohshme të personelit. Për stokun përdoret gjendja më 31 dhjetor 2025. Kur përdoren të dhëna të vitit 2026, ato shërbejnë për rakordimin e personelit dhe jo për të ndryshuar mesataren e fluksit të periudhës bazë.

7.2 Formula për fluksin normal

Organika minimale operacionale llogaritet duke pjesëtuar mesataren vjetore të çështjeve të reja me produktivitetin referues. Produktiviteti referues mund të jetë standardi sasior i miratuar nga KLGJ ose produktiviteti faktik i matur. Në këtë studim standardi i KLGJ-së përdoret si bazë e rekomandimit për shkallën e parë, ndërsa produktiviteti faktik përdoret si kontroll dhe si bazë orientuese për nivelet ku nuk ka model të plotë të peshimit.

Formula e përmbledhur është: J minimal[2] = hyrjet mesatare vjetore / produktiviteti referues. Rezultati rrumbullakohet lart, sepse një pjesë dhjetore e vendit nuk krijon trupë gjykuese. Megjithatë, rrumbullakosja bëhet në nivel gjykate dhe jo vetëm në totalin kombëtar, për të respektuar madhësinë minimale dhe nevojën e zëvendësimit.

7.3 Formula për rikuperimin e stokut

Kapaciteti i rikuperimit llogaritet duke shtuar në fluksin mesatar pjesën e stokut që duhet të përfundojë çdo vit. Për objektivin pesëvjeçar, përdoret një e pesta e stokut të verifikuar. Formula është: J rikuperim [3]= (hyrjet mesatare + stoku i rikuperimit / 5) / produktiviteti referues. Stoku i rikuperimit duhet të përbëhet nga çështjet që kanë kaluar afatin standard.

Formula supozon se fluksi i ri dhe produktiviteti mbeten afërsisht të qëndrueshëm. Për këtë arsye, rezultati duhet të rishikohet çdo vit. Nëse hyrjet rriten, kapaciteti mund të kërkojë rishpërndarje. Nëse stoku ulet më shpejt, vendet e orientuara për rikuperim mund të drejtohen te një gjykatë tjetër me nevojë, pa ndryshuar domosdoshmërisht tavanin kombëtar.

[2] J_min (numri minimal i gjyqtarëve) është numri më i ulët i gjyqtarëve që i nevojitet një gjykate për të përballuar ngarkesën e pritshme dhe për të garantuar funksionimin normal të saj, pa përfshirë rezervën funksionale për mungesa ose vakanca.
[3] J_rikuperim (gjyqtarët për rikuperimin e stokut) është numri shtesë i përkohshëm i gjyqtarëve që nevojitet, përtej organikës së zakonshme, për të reduktuar brenda një afati të përcaktuar stokun e çështjeve të prapambetura.

7.4 Shtresa korrigjuese për mungesat funksionale

Formula e ngarkesës llogarit gjyqtarët që duhen për punën gjyqësore. Ajo nuk kompenson gjyqtarët që mbajnë statusin, por nuk janë të disponueshëm për gjykim. Prandaj, mbi 84 vendet operacionale, shtohet një rezervë funksionale prej 18 vendesh. Aktivizimi bëhet vetëm për FTE të dokumentuara dhe destinacioni ndjek gjykatën që humbet kapacitetin. Kështu, komponenti operacional dhe rezerva nuk përdorin të njëjtën arsye dhe nuk mund të numërohen dy herë për të njëjtin rast.

Ndarja fillestare 10 vende në shkallën e parë dhe 8 në apel është një çelës planifikimi, jo një shpërndarje e pakthyeshme. Nëse regjistri nominal tregon një origjinë tjetër të mungesave funksionale, KLGJ duhet të korrigjojë ndarjen me akt të arsyetuar, pa tejkaluar tavanin 18. Në çdo rast duhet të ruhet gjurma ndërmjet vendit të rezervës dhe FTE-së së humbur që ai kompenson.

7.5 Metoda e rivlerësimit territorial të 44 vendeve

Rivlerësimi i juridiksionit të përgjithshëm përdor të dhënat e plota të vitit 2025 nga Raporti Vjetor i KLGJ-së. Ngarkesa totale, stoku në fillim plus çështjet e ardhura ishte 123 912 çështje. Tirana përfaqësonte 52 900 ose 42,7 %, ndërsa të gjitha gjykatat e tjera 71 012 ose 57,3 %. Ndarja e pastër proporcionale e 44 vendeve jep rreth 25 vende jashtë Tiranës. Modeli shton një vend korrigjues territorial, sepse jashtë Tiranës presioni është i shpërndarë në disa qendra dhe treguesit CR e DT janë të pabarabartë. Rezultati është 26 vende jashtë Tiranës dhe 18 në Tiranë.

Për të shmangur shpërndarjen simbolike të një ose dy vendeve në shumë gjykata, faza e parë identifikon qendrat rajonale me ngarkesë totale 2025 të paktën 6 000 çështje. Ky prag është i barasvlershëm me punën vjetore të 15 gjyqtarëve sipas standardit 400 dhe plotësohet nga Durrësi, Elbasani, Fieri, Korça, Shkodra dhe Vlora. Gjykatat nën prag nuk humbasin asnjë vend ekzistues dhe organika e tyre ruhet si dysheme, vakancat duhet të plotësohen dhe mungesat institucionale mund të kompensohen nga rezerva funksionale.

Brenda gjashtë qendrave, 26 vendet ndahen me një rezultat të ponderuar, ku 75 % kërkesa e rikuperimit, e llogaritur si hyrjet 2025 plus një e pesta e stokut përfundimtar, 15 % pjesa e stokut, 8 % tejkalimi relativ i DT-së ndaj mesatareve 270 ditë civile dhe 92 ditë penale dhe 2 % deficiti i CR-së nën 100 për qind. Peshat janë parametra vendimmarrjeje të dukshëm në aneksin Excel dhe mund të ndryshohen vetëm me arsyetim të dokumentuar.

7.6 Rregullat e vendimmarrjes

- Organika ekzistuese ruhet si dysheme në këtë fazë. Çdo ulje kërkon analizë të veçantë të madhësisë minimale, aksesit territorial dhe specializimit.
- Rezultatet rrumbullakosen lart sipas gjykatës dhe kontrollohen me përbërjen e trupave dhe me nevojën për zëvendësim.
- Vendet e rezervës funksionale janë shtesë mbi 84 vendet operacionale dhe nuk numërohen njëkohësisht si vakanca të zakonshme ose si nevojë nga ngarkesa.
- Vendet e lidhura me rikuperimin monitorohen me objektiva vjetorë për CR, DT dhe stokun e vjetër.
- Personeli jogjyqtar, infrastruktura dhe buxheti miratohen si pjesë e së njëjtës paketë zbatimi.

8. Rezultatet për gjykatat e shkallës së parë

Në shkallën e parë propozohen 64 vende operacionale, 44 për juridiksionin e përgjithshëm, 18 për juridiksionin administrativ dhe 2 për gjykatën e posaçme. Mbi to planifikohen 10 vende të rezervës funksionale, të cilat nuk u caktohen paraprakisht gjykatave, por aktivizohen sipas origjinës së mungesës së dokumentuar. Kështu, shtesa e përhershme e shkallës së parë është 74 vende dhe struktura e këtij niveli kalon nga 287 në 361 gjyqtarë.

Për juridiksionin e përgjithshëm, modeli sasior jep 209,1 gjyqtarë për fluksin normal dhe 229,0 për fluksin plus rikuperimin pesëvjeçar sipas standardit 400 çështje në vit. Struktura aktuale është 235. Ky rezultat tregon se formula

kombëtare, e vetme, nuk prodhon automatikisht nevojë për 44 vende të reja. Shtesa 44 mbështetet në një shtresë të dytë vlerësimi kryesisht nga përqendrimi i stokut në gjykatat e mëdha, boshllëqet e vazhdueshme të FTE-së, nevoja për seksione funksionale, zëvendësimi, luhatjet e fluksit dhe objektivi që gjykatat të mos varen vazhdimisht nga delegimet.

Gjykata	Struktura	Ngarkesa totale 2025	Stoku në fund 2025	Shtesa operacionale	Struktura e propozuar
Berat	8	3 608	917	0	8
Dibër	7	2 208	506	0	7
Durrës	23	11 956	4 476	6	29
Elbasan	18	9 852	4 193	5	23
Fier	21	10 764	2 822	6	27
Gjirokastër	7	3 330	1 257	0	7
Korçë	15	6 831	2 281	3	18
Kukës	7	2 228	474	0	7
Lezhë	11	4 559	1 130	0	11
Sarandë	7	3 110	870	0	7
Shkodër	15	6 082	1 551	3	18
Tiranë	80	52 900	17 491	18	98
Vlorë	16	6 484	1 799	3	19
TOTALI	**235**	**123 912**	**39 767**	**44**	**279**

Ngarkesa totale 2025 është shuma e çështjeve të mbartura në fillim të vitit dhe çështjeve të ardhura gjatë vitit. Ajo nuk është e njëjtë me fluksin e ri, por tregon vëllimin e plotë që gjykata kishte për administrim. “Shtesa operacionale” është vend i ri mbi strukturën, jo plotësim i diferencës ndërmjet strukturës dhe FTE-së. Para çdo emërimi, secila gjykatë duhet të ketë fletë rakordimi që paraqet veçmas vendet ekzistuese të pazëna, vendet e reja dhe FTE-në e humbur për arsye funksionale.

8.1 Juridiksioni i përgjithshëm

8.1.1 Ndarja Tiranë–jashtë Tiranës

Në vitin 2025, gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm të shkallës së parë administruan 123 912 çështje. Tirana kishte 52 900 çështje ose 42,7 %, gjykatat e tjera 71 012 ose 57,3 %. Një ndarje vetëm proporcionale e 44 vendeve do të jepte rreth 25 vende jashtë Tiranës dhe 19 në Tiranë. Rivlerësimi cakton 26 jashtë Tiranës dhe 18 në Tiranë, sepse një sistem me disa qëndra rajonale ka nevojë për një korrigjim minimal të riskut territorial dhe një vend më shumë jashtë Tiranës e bën të mundur formimin e kapaciteteve të plota në gjykatat ku presioni shfaqet njëkohësisht në stok, CR ose DT.

Korrigjimi nuk ul rëndësinë e Tiranës. Ai shmang që rritja të përqendrohet pothuajse e gjitha në një gjykatë, ndërsa Durrësi, Elbasani, Fieri, Korça, Shkodra dhe Vlora mbajnë së bashku një pjesë të madhe të shërbimit rajonal. Gjykatat jashtë Tiranës nuk ndahen sipas popullsisë së qarkut, sepse juridiksioni, lëvizja e çështjeve dhe harta gjyqësore nuk përputhen mekanikisht me popullsinë. Ato ndahen sipas ngarkesës së dokumentuar dhe treguesve të performancës së vetë gjykatës.

Gjykata	Ngarkesa 2025	Stoku	CR civ./pen.	DT civ./pen.	Rezultati	Kuota	Shtesa
Durrës	11 956	4 476	105% / 96%	311 / 147	22,74%	5,913	6

Gjykata	Ngarkesa 2025	Stoku	CR civ./pen.	DT civ./pen.	Rezultati	Kuota	Shtesa
Elbasan	9 852	4 193	175% / 106%	367 / 221	18,65%	4,849	5
Fier	10 764	2 822	91% / 95%	359 / 38	22,32%	5,802	6
Korçë	6 831	2 281	99% / 92%	319 / 125	14,43%	3,753	3
Shkodër	6 082	1 551	109% / 101%	277 / 54	10,78%	2,804	3
Vlorë	6 484	1 799	109% / 104%	242 / 56	11,07%	2,879	3
TOTALI	**51 969**	**17 122**	—	—	**100,00%**	**26,000**	**26**

Metoda cakton fillimisht pjesën e plotë të kuotës dhe më pas vendet e mbetura sipas mbetjes dhjetore më të madhe. Dyshemeja e kuotave jep 21 vende, 5 vendet e mbetura u kalojnë Durrësit, Vlorës, Elbasanit, Shkodrës dhe Fierit. Korça mbetet me tre vende, sepse mbetja e saj është e gjashta. Kjo metodë ruan totalin 26 dhe e bën të kontrollueshme çdo lëvizje të ardhshme të peshave ose të të dhënave.

8.1.2 Gjykata e Durrësit: 6 vende

Durrësi merr 6 vende dhe kalon nga 23 në 29. Në vitin 2025 kishte 7 525 çështje të ardhura, ngarkesë totale 11 956 dhe stok përfundimtar 4 476, stoku më i lartë jashtë Tiranës. CR-ja civile 105 % tregon se në atë segment gjykata ka përfunduar pak më shumë çështje se sa kanë ardhur, por CR-ja penale 96 % tregon krijim të ri stoku. DT-ja 311 ditë në çështjet civile dhe 147 ditë në ato penale është mbi mesataren e grupit në të dy fushat. Ky kombinim e vendos Durrësin në pozitë të qartë prioritare pasi gjykata ka volum të madh, stok të konsiderueshëm dhe kohë teorike të lartë përpunimi.

Shtesa 6 nuk zëvendëson detyrimin për të plotësuar vendet ekzistuese dhe as nuk legjitimon mbajtjen e një FTE-je të ulët. Ajo krijon kapacitet strukturor për seksionet civile e penale, për zëvendësimin dhe për një ekip rikuperimi të stokut. Aktivizimi duhet të bëhet në dy hapa, ku hapi i parë pasi të jetë rakorduar organika faktike dhe hapi i dytë pasi raporti gjashtëmujor të tregojë përdorimin e vendeve, uljen e stokut të vjetër dhe një CR të qëndrueshme mbi 100 për qind në të dy fushat.

8.1.3 Gjykata e Elbasanit: 5 vende

Elbasani merr 5 vende dhe kalon nga 18 në 23. Ngarkesa totale 9 852 dhe stoku përfundimtar 4 193 tregojnë se rreth 42,6 % e portofolit të administruar në vit mbeti i papërfunduar në fund të tij. CR-ja shumë e lartë civile 175 % dhe CR-ja penale 106 % janë sinjal pozitiv për ritmin e përfundimeve, por nuk e zhdukin nevojën. DT-ja mbetet 367 ditë për civilen dhe 221 ditë për penalen, dukshëm mbi mesataret 270 dhe 92. Kjo situatë është tipike kur gjykata ul stokun, por ende mban një portofol të vjetër dhe për këtë arsye CR-ja dhe DT-ja duhet të lexohen së bashku.

Pesë vendet synojnë ta bëjnë uljen e stokut të qëndrueshme, të ruajnë seksionet dhe të shmangin që përmirësimi i një viti të humbasë nga largimet ose ngritjet në detyrë. Para aktivizimit të valës së fundit, stoku duhet të ndahet sipas moshës dhe natyrës së çështjes. Nëse numri i çështjeve mbi tre dhe pesë vjet ulet më shpejt se trajektorja, vendi ende i paaktivizuar mund të rishikohet dhe gjyqtarët e emëruar nuk duhet të trajtohen si kapacitet i lëvizshëm jashtë garancive ligjore.

8.1.4 Gjykata e Fierit: 6 vende

Fieri merr 6 vende dhe kalon nga 21 në 27. Me 8 493 çështje të ardhura, ai kishte fluksin më të lartë jashtë Tiranës dhe ngarkesë totale 10 764. Në të njëjtin vit, CR-ja civile ishte 91 % dhe ajo penale 95 %, të dyja nën pragun 100 për qind, çka do të thotë se gjykata nuk po mbyllte aq çështje sa merrte. DT-ja civile 359 ditë është gjithashtu dukshëm mbi mesataren e grupit, megjithëse DT-ja penale 38 ditë është e favorshme. Rezultati i ponderuar 22,32 % është pothuajse i barabartë me atë të Durrësit dhe prodhon kuotën 5,802, të rrumbullakosur në 6.

Fieri është rasti ku shtesa lidhet më drejtpërdrejt me parandalimin e stokut të ri. Vala e parë duhet të drejtohet te seksionet ku CR-ja është nën 100 për qind dhe ku ngarkesa e peshuar është më e lartë. Objektivi minimal i vitit të parë duhet të jetë kthimi i CR-së mbi 100 për qind pa ulur cilësinë dhe pa rritur shtyrjet; objektivi i dytë është ulja e DT-së civile.

Nëse vendet ekzistuese mbeten bosh, shtesa strukturore nuk do të prodhojë këto rezultate, ndaj plotësimi i organikës aktuale dhe emërimet e reja duhet të programohen bashkë.

8.1.5 Gjykata e Korçës: 3 vende

Korça merr 3 vende dhe kalon nga 15 në 18. Ajo kishte ngarkesë totale 6 831 dhe stok 2 281. Të dy treguesit e CR-së ishin nën 100 %, 99 % në çështjet civile dhe 92 % në ato penale. Po ashtu, DT-ja 319 ditë civile dhe 125 ditë penale kalonte mesataret përkatëse. Korça, nuk përzgjidhet thjesht sepse është qendër rajonale, por të katër treguesit e fluksit dhe kohës tregojnë presion të vazhdueshëm. Kuota e formulës është 3,753. Për shkak të renditjes së mbetjeve, ndarja përfundimtare është 3 dhe jo 4, duke ruajtur kufirin kombëtar 44.

Aktivizimi duhet të përqendrohet fillimisht në segmentin penal, ku deficiti i CR-së është më i madh, dhe në portofolin civil me moshë të lartë. Raporti vjetor duhet të tregojë nëse të tre vendet e rrisin CR-në mbi 100 % dhe ulin DT-në. Nëse pas dy vjetësh hyrjet ndryshojnë ndjeshëm, Korça duhet të rivlerësohet me të njëjtën formulë, jo me një ulje ose rritje ad hoc.

8.1.6 Gjykatat e Shkodrës dhe Vlorës: nga 3 vende

Shkodra merr 3 vende dhe kalon nga 15 në 18. Ngarkesa 6 082 e vendos pak mbi pragun e qendrës prioritare. CR-ja 109 % civile dhe 101 % penale tregon kontroll të fluksit, ndërsa DT-ja civile 277 ditë është pak mbi mesataren 270. DT-ja penale 54 ditë është më e favorshme. Shtesa nuk është përgjigje ndaj një kolapsi të performancës, por masë për të ruajtur seksionet, mbulimin e një zone të gjerë dhe aftësinë për të ulur stokun 1 551 pa cenuar fluksin e ri. Kuota 2,804 dhe mbetja e lartë e çojnë ndarjen në 3.

Vlora merr 3 vende dhe kalon nga 16 në 19. Ajo kishte ngarkesë 6 484, stok 1 799, CR 109 % civile dhe 104 % penale, si dhe DT 242 e 56 ditë, çka tregon se treguesit e performancës janë më të mirë se mesatarja. Arsyeja e shtesës është kryesisht volumi dhe roli si qendër rajonale, jo një deficit akut CR/DT. Kuota 2,879 është e treta për nga mbetja dhe prodhon 3 vende. Për këtë arsye, aktivizimi në Vlorë duhet të jetë më i kushtëzuar, ku fillimisht plotësimi i vendeve aktuale dhe verifikimi i fluksit, pastaj vendet e reja sipas nevojës së seksioneve dhe moshës së stokut.

8.1.7 Gjykata e Tiranës: 18 vende

Tirana merr 18 vende dhe kalon nga 80 në 98. Në vitin 2025 ajo kishte 34 415 çështje të ardhura, ngarkesë totale 52 900 dhe stok 17 491. Këto përfaqësojnë 42,7 % të ngarkesës totale dhe rreth 44 % të stokut të të gjithë juridiksionit. CR-ja ishte 103 % si për civilen, ashtu edhe për penalen, ndërsa DT-ja civile 313 ditë ishte mbi mesataren 270. DT-ja penale 67 ditë ishte më e favorshme. Pra, Tirana mbetet përfituesi më i madh i vetëm i paketës, por jo përfituesi i shumicës së vendeve.

Ndarja proporcionale do t'i jepte rreth 19 vende pasi korrigjimi territorial e vendos në 18 dhe i çon 26 jashtë Tiranës. Struktura 98 është mbi rezultatin rreth 92 të modelit pesëvjeçar të rikuperimit, ndaj vendet përtej këtij rezultati duhet të aktivizohen vetëm pas plotësimit të vakancave, peshimit sipas seksioneve dhe verifikimit të hapësirave e administratës mbështetëse. Ky kusht e mban propozimin të lidhur me rezultatet dhe jo me rritjen mekanike të organikës.

8.1.8 Gjykatat e tjera: ruajtje e organikës pa shtesë në fazën I

Berati, Dibra, Gjirokastra, Kukësi, Lezha dhe Saranda nuk marrin vend të ri operacional nga 44-shja në fazën e parë. Ky përfundim nuk do të thotë se këto gjykata janë pa nevoja dhe as se organika e tyre mund të ulet. Struktura ekzistuese ruhet si dysheme për aksesin territorial, vazhdimësinë, specializimin minimal dhe zëvendësimin. Vendet e pazëna duhet të plotësohen. Kur një gjyqtar largohet për mandat ose funksion institucional, mungesa e dokumentuar mund të kompensohet nga rezerva 18. Nëse fluksi, stoku ose peshimi i çështjeve ndryshon, gjykata hyn në rishikimin vjetor me të njëjtat kritere.

Zgjedhja për të mos shpërndarë nga një vend në çdo gjykatë është e qëllimshme. Një vend i vetëm i shpërndarë gjerësisht mund të mos krijojë seksion, trupë ose ekip rikuperimi dhe e hollon ndikimin e paketës. Përqendrimi fillestar te gjashtë qendrat e mëdha rajonale prodhon kapacitet të përdorshëm, ndërsa mbrojtja e gjykatave më të vogla sigurohet nga

dyshemeja strukturore, plotësimi i vakancave, mekanizmat e ligjshëm të mobilitetit dhe rezerva funksionale. Ky ekuilibër duhet të kontrollohet çdo vit për të shmangur si centralizimin e tepruar, ashtu edhe shpërndarjen joefektive.

8.2 Juridiksioni administrativ

Gjykata	Struktura	FTE në model	Modeli i rikuperimit	Shtesa operacionale	Struktura e propozuar
Administrative Lushnjë	9	8	7,7	2	11
Administrative Tiranë	27	21	38,3	16	43
TOTALI	**36**	**29**	**46,0**	**18**	**54**

Nga 18 vendet administrative, 16 i caktohen Tiranës dhe 2 Lushnjës. Tirana përballon rreth 11 976 hyrje mesatare dhe stok 7 209 çështje, ku modeli i rikuperimit jep 38,3 FTE, 11,3 mbi strukturën 27. Propozimi për strukturë 43 përfshin rreth 12 vende të mbështetura drejtpërdrejt nga modeli i rrumbullakosur dhe 4 vende si marzh për kompleksitetin, luhatjet normative dhe zëvendësimin. Katër vendet e fundit duhet të aktivizohen vetëm pas matjes së kohës së punës sipas llojit të çështjes.

Lushnja merr 2 vende dhe kalon nga 9 në 11, megjithëse modeli i rikuperimit jep 7,7 FTE. Kjo shtesë ka funksion të kufizuar sigurie për vazhdimësinë, specializimin dhe mbulimin e mungesave në një gjykatë relativisht të vogël. Nëse treguesit dyvjeçarë tregojnë kapacitet të pashfrytëzuar, këto vende duhet të jenë ndër të parat që rishikohen përpara aktivizimit ose që ridrejtohen sipas procedurave ligjore.

8.3 Gjykata e posaçme dhe përmbledhja e nivelit

Për Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë propozohen 2 vende operacionale, duke e çuar strukturën nga 16 në 18. Materialet e dorëzuara nuk përmbajnë model të plotë të peshimit për këtë gjykatë, për rrjedhojë, shtesa është e kufizuar dhe duhet të verifikohet me kompleksitetin, kohën e seancave, volumin e provave dhe nevojën për formimin e trupave. Ajo nuk duhet të zgjerohet pa analizë të posaçme.

Grupi i gjykatave	Struktura aktuale	Shtesa operacionale	Pas 84 vendeve	Rezervë funksionale	Struktura pas rezervës
Juridiksioni i përgjithshëm, shkalla e parë	235	44	279	—	—
Administrative, shkalla e parë	36	18	54	—	—
E posaçme, shkalla e parë	16	2	18	—	—
TOTALI I SHKALLËS SË PARË	**287**	**64**	**351**	**10**	**361**

Dhjetë vendet e rezervës funksionale paraqiten vetëm në totalin e nivelit, sepse nuk janë vende të zakonshme të shpërndara paraprakisht. Ato vendosen në gjykatën nga e cila largohet përkohësisht FTE-ja e dokumentuar. Nëse, për shembull, një gjyqtar i Durrësit ushtron mandat në KLGJ, vendi i rezervës lidhet me humbjen e Durrësit dhe nuk mund të përdoret njëkohësisht si shtesë e përgjithshme në një gjykatë tjetër.

9. Rezultatet për apelin, gjykatat e posaçme dhe Gjykatën e Lartë

Në nivel apeli propozohen 20 vende operacionale, 6 për Apelin e Juridiksionit të Përgjithshëm, 12 për Apelin Administrativ dhe 2 për Apelin e Posaçëm. Mbi to planifikohen 8 vende të rezervës funksionale. Struktura e zakonshme e apelimit kalon kështu nga 111 në 131 pas shtesës operacionale dhe në 139 pas rezervës funksionale. Ndarja i jep peshë më të madhe juridiksionit administrativ, ku modeli i rikuperimit tregon deficit strukturor të drejtpërdrejtë.

Për apelin dhe Gjykatën e Lartë, hyrjet janë kontrolluar përmes identitetit të fluksit, ku stoku përfundimtar plus çështjet e përfunduara minus stoku fillestar. Produktiviteti faktik përdoret vetëm si tregues orientues, sepse puna në trupë dhe kompleksiteti nuk janë plotësisht të krahasueshme me gjykimin në shkallën e parë. Për shpërndarjen përfundimtare nevojitet peshim sipas llojit të çështjes, rolit të gjyqtarit në trupë, kohës së studimit dhe numrit të seancave.

Gjykata	Stoku 2025	CR	DT ditë	Struktura	Efektivë	Rikuperimi 5 vjet	Shtesa operacionale	Struktura e propozuar
Apeli i juridiksionit të përgjithshëm	45 876	72,7%	1 507	78	41	76	6	84
Apeli administrativ	24 530	83,6%	2 634	22	18	44	12	34
Apeli i posaçëm	—	—	—	11	10	Pa model të plotë	2	13
Gjykata e Lartë	16 445	282,6%	873	19	15	13	9 të përkohshëm	19 + 9

9.1 Apeli i juridiksionit të përgjithshëm

Struktura 78 është pranë rezultatit 76 të skenarit të rikuperimit, por numri efektiv 41 është shumë më i ulët. Përparësia e parë është plotësimi i 37 vendeve që mungojnë ndaj strukturës së sotme. Gjashtë vendet e reja e çojnë strukturën në 84 dhe krijojnë marzh për seksionet, formimin e trupave, zëvendësimin dhe luhatjet ndërmjet fushave civile e penale. Ato nuk paraqiten si diferencë e drejtpërdrejtë e formulës, sepse formula jep 76, ku janë korrigjim organizativ që duhet aktivizuar pasi të jetë provuar se plotësimi i strukturës 78 nuk mjafton për të arritur CR mbi 100 % dhe ulje të qëndrueshme të stokut.

Stoku 45 876, CR 72,7 % dhe DT teorik 1 507 ditë tregojnë se problemi nuk mund të reduktohet vetëm te numri formal. Duhet të krijohen ekipe të dedikuara për grupet e vjetra të çështjeve, të ndahet stoku sipas moshës dhe llojit dhe të garantohet mbështetje e mjaftueshme juridike. Gjashtë vendet e reja duhet të lidhen me seksionet ku peshimi i çështjeve dhe mosha e stokut tregojnë ndikimin më të madh, jo të shpërndahen në mënyrë të barabartë.

9.2 Apeli administrativ

Apeli Administrativ paraqet stok 24 530 çështje, CR 83,6 % dhe DT teorik 2 634 ditë për vitin 2025. Struktura 22 është pranë nevojës minimale nga fluksi, por dukshëm nën nevojën 44 të skenarit pesëvjeçar të rikuperimit. Për këtë arsye, kjo gjykatë merr 12 nga 20 vendet operacionale të apelit dhe kalon në strukturë 34. Kjo është rritja më e madhe proporcionale në nivel apeli dhe lidhet drejtpërdrejt me kombinimin e stokut, CR-së nën 100 % dhe kohës së lartë teorike të përpunimit.

Edhe pas shtesës, struktura 34 mbetet 10 vende nën rezultatin 44 të modelit. Diferenca nuk lihet pa trajtim, ajo duhet të mbulohet fillimisht me plotësimin e katër vendeve që mungojnë ndaj strukturës aktuale, me personel të shtuar juridik, panele të dedikuara, menaxhim aktiv të portofolit dhe objektiva vjetore. Në rishikimin e vitit të dytë, nëse CR mbetet nën 100 % dhe stoku i vjetër nuk ulet sipas trajektores, KLGJ duhet të vlerësojë ridrejtimin e vendeve të paaktivizuara nga nivele të tjera ose një rishikim të ri të organikës.

9.3 Gjykatat e posaçme

Për Apelin e Posaçëm propozohen 2 vende, duke e çuar strukturën nga 11 në 13. Materialet e dorëzuara nuk japin model të plotë të peshimit, ndaj shtesa është e kufizuar dhe mbështetet në kompleksitetin, gjykimin në trupë, volumin e provave dhe nevojën për zëvendësim. Para aktivizimit duhet të përgatitet një studim i posaçëm për ngarkesës me kohën mesatare sipas kategorisë së çështjes. Në mungesë të këtij verifikimi, vendet duhet të qëndrojnë të paaktivizuara brenda tavanit shumëvjeçar.

9.4 Gjykata e Lartë

Gjykata e Lartë ka arritur CR shumë mbi 100 % dhe ka ulur stokun. Ky rezultat tregon kapacitet të lartë përpunimi, por stoku vazhdon të jetë i konsiderueshëm dhe përfshin çështje të vjetra. Formula e thjeshtë e fluksit jep numër më të ulët se organika 19, por kjo formulë nuk kap funksionin unifikues, punën në kolegje, vendimet për njësimin ose ndryshimin e praktikës dhe kompleksitetin e rekursit. Organika 19 duhet të plotësohet dhe të ruhet.

Kapaciteti shtesë 9 propozohet si masë e jashtëzakonshme për një mandat. Ai duhet të ketë portofol të identifikuar, objektiv vjetor, raportim tremujor dhe datë përfundimi. Zgjidhja ligjore duhet të garantojë pavarësinë, përzgjedhjen transparente dhe paanshmërinë. Nëse emërimi i anëtarëve të përkohshëm bie ndesh me kuadrin kushtetues ose ligjor, paketa duhet të shndërrohet në një mekanizëm tjetër të ligjshëm, si forcim i kapaciteteve të këshilltarëve, organizim i posaçëm i kolegjeve ose një zgjidhje normative.

9.5 Përmbledhja e nivelit të apelit

Grupi i gjykatave	Struktura aktuale	Shtesa operacionale	Pas 84 vendeve	Rezervë funksionale	Struktura pas rezervës
Apeli i juridiksionit të përgjithshëm	78	6	84	—	—
Apeli administrativ	22	12	34	—	—
Apeli i posaçëm	11	2	13	—	—
TOTALI I APELIT	**111**	**20**	**131**	**8**	**139**

Tetë vendet e rezervës së apelit nuk i shtohen paraprakisht njërës prej tri gjykatave. Ato lidhen me origjinën e gjyqtarëve që ushtrojnë funksione institucionale jashtë gjykatës. Ky mekanizëm është veçanërisht i rëndësishëm në apel, sepse mungesa e një gjyqtari mund të pengojë formimin e disa trupave dhe të ketë ndikim më të madh se humbja numerike e një FTE-je.

10. Arsyetimi i plotë i vendimmarrjes së propozuar

Pesë çështjet e mëposhtme përbëjnë bërthamën e vendimmarrjes. Secila ka bazë, qëllim dhe kontroll të ndryshëm. Vendimi përfundimtar duhet t'i ndajë qartë 84 vendet operacionale, 18 vendet e rezervës, hendekun efektiv 108 të strukturës ekzistuese, 9 vendet e përkohshme në Gjykatën e Lartë dhe personelin mbështetës. Brenda hendekut 108 duhen dalluar 74 vendet e pazëna dhe 34 FTE e humbjes funksionale neto. Vetëm kjo ndarje e bën zbatimin të matshëm dhe shmang paraqitjen e të njëjtit boshllëk si dy nevoja të ndryshme.

Pika	Qëllimi	Instrumenti	Kontrolli kryesor
84 vende operacionale	Kapacitet i qëndrueshëm gjykues	Rritja e organikës dhe aneksi sipas gjykatave	Aktivizim me faza dhe rishikim vjetor
18 vende rezervë	Kompensimi i mungesave funksionale	Regjistër nominal i FTE-së së munguar	Ndalim i numërimit të dyfishtë
Hendeku efektiv 108	74 vende të pazëna + 34 FTE neto funksionale	Plan rekrutimi dhe regjistër FTE	Raportim tremujor i kapacitetit real
9 vende në Gjykatën e Lartë	Ulja e stokut të vjetër	Masë normative ose mekanizëm tjetër i ligjshëm	Mandat i vetëm dhe kontroll juridik
Minimumi 336 + 56 punonjës	Kapacitet mbështetës operacional	Organika e administratës dhe programi buxhetor	Aktivizim paralel me gjyqtarët; analizë deri në 421

10.1 Miratimi i 84 vendeve operacionale të përhershme

Shtesa prej 84 vendesh është tavani i propozuar për rritjen operacionale të përhershme në shkallën e parë dhe apel. Ajo e çon organikën kombëtare nga 417 në 501 para llogaritjes së rezervës funksionale. Numri nuk është rezultat i shumëzimit mekanik të popullsisë me një mesatare europiane. Ai është një vlerësim shumëvjeçar që bashkon modelin sasior, stokun, FTE-në, nevojën për trupa e seksione dhe qëndrueshmërinë territoriale.

Ndarja është 64 vende në shkallën e parë dhe 20 në apel. Në shkallën e parë, 44 vende shkojnë në juridiksionin e përgjithshëm, 18 në juridiksionin administrativ dhe 2 në gjykatën e posaçme. Në apel, 6 vende shkojnë në juridiksionin e përgjithshëm, 12 në juridiksionin administrativ dhe 2 në gjykatën e posaçme. Ky konfigurim kombinon peshën e fluksit në shkallën e parë me deficitin veçanërisht të fortë të rikuperimit në Apelin Administrativ.

Niveli dhe juridiksioni	Shtesa operacionale
Shkalla e parë, juridiksioni i përgjithshëm	44
Shkalla e parë administrative	18
Shkalla e parë e posaçme	2
Apeli i juridiksionit të përgjithshëm	6
Apeli administrativ	12
Apeli i posaçëm	2
TOTALI	**84**

Miratimi i numrit kombëtar duhet të pasohet nga aneksi sipas gjykatave. Aneksi duhet të përdorë pesë kritere, mesataren trevjeçare të hyrjeve, stokun që ka kaluar afatin standard, FTE-në reale, peshën e çështjeve dhe madhësinë minimale funksionale. Asnjë gjykatë nuk duhet të marrë vende vetëm sepse ka stok të lartë, nëse stoku lidhet me shkaqe procedurale që nuk zgjidhen me gjyqtarë shtesë. Në të njëjtën mënyrë, një gjykatë me stok më të ulët, por me hyrje të larta, nuk duhet të lihet pa kapacitet parandalues.

Paketa duhet të zbatohet me faza deri në vitin 2030. Numri i vendeve të aktivizuara çdo vit duhet të lidhet me daljet nga Shkolla e Magjistraturës, procedurat e ngritjes në detyrë dhe mundësinë buxhetore. Vendet e paaktivizuara nuk duhet të shpërndahen automatikisht. KLGJ duhet të rikonfirmojë prioritetet para çdo cikli emërimesh, sepse fluksi dhe stoku mund të ndryshojnë gjatë periudhës së zbatimit.

Për vendimmarrje rekomandohet që akti të miratojë numrin 84, ndarjen 64 me 20, shpërndarjen fillestare sipas juridiksioneve, aneksin sipas gjykatave dhe rishikimin vjetor. Vendet e reja janë të përhershme në organikë, por aktivizimi i tyre duhet të bëhet me faza. Për vendet që shkojnë dukshëm mbi rezultatin e formulës, akti duhet të kërkojë një vendim të dytë aktivizimi të mbështetur në të dhënat e vitit pararendës. Kjo e ruan seriozitetin e numrit 84 pa e kthyer atë në punësim automatik të pambështetur nga rezultatet.

10.2 Rezerva funksionale prej 18 vendesh

Rezerva funksionale adreson një problem që nuk shfaqet saktë në numrin formal të organikës. Kur një gjyqtar emërohet ose caktohet për një periudhë të gjatë në një institucion tjetër, vendi mund të mbetet i zënë juridikisht, ndërsa gjykata humbet kapacitetin e gjykimit. Pa një mekanizëm kompensues, gjykata e origjinës përballon të njëjtin fluks me më pak FTE dhe krijon stok, megjithëse në dokumentet e personelit mund të mos rezultojë vakancë.

Numri 18 përbën një tavan fillestar. Ai duhet të verifikohet me regjistër nominal para aktivizimit. Për çdo gjyqtar duhet të dokumentohen institucioni pritës, funksioni, baza ligjore, data e fillimit, kohëzgjatja, gjykata e origjinës dhe FTE-ja që humbet. Nëse angazhimi është me kohë të pjesshme, kompensimi duhet të pasqyrojë vetëm pjesën e humbur. Për shembull, një angazhim 50 për qind prodhon nevojë 0,5 FTE dhe jo automatikisht një vend të plotë.

Rezerva ndahet fillimisht në 10 vende për shkallën e parë dhe 8 për apelin. Kjo ndarje është çelës planifikimi dhe mund të ndryshojë sipas origjinës së gjyqtarëve që ushtrojnë funksione jashtë gjykatave. KLGJ duhet ta rishikojë të paktën një herë në vit. Nëse mungesat e dokumentuara janë më pak se 18 FTE, pjesa përkatëse e rezervës mbetet e paaktivizuar; ajo nuk duhet të përdoret si shtesë e zakonshme nga ngarkesa pa një rishikim të shprehur të vendimit dhe të arsyes së vendit.

Vendet e rezervës janë të përhershme në organikën kombëtare, sepse gjyqtarët e emëruar në to duhet të kenë siguri statusi. Funksioni i rezervës është i lëvizshëm në nivel planifikimi, jo statusi i gjyqtarit. Rishpërndarja duhet të respektojë procedurat ligjore, palëvizshmërinë dhe, kur kërkohet, pëlqimin. Kthimi i gjyqtarit të angazhuar jashtë gjykatës nuk mund të përdoret për të cenuar mandatin ose pozicionin e gjyqtarit të emëruar në vendin shtesë.

Raportimi vjetor duhet të tregojë sa vende rezervë janë aktivizuar, për cilën mungesë, në cilën gjykatë dhe me çfarë rezultati. Kjo transparencë parandalon që rezerva të kthehet në një shtesë të pashpjeguar dhe i lejon KLGJ-së të korrigjojë numrin në rishikimin e ardhshëm të organikës.

10.3 Plotësimi i vakancave dhe shmangia e numërimit të dyfishtë

Sistemi ka hendek efektiv 108 kur krahasohet organika 417 me numrin efektiv 309. Ky hendek përbëhet nga 74 vende të pazëna dhe 34 FTE neto të humbjes funksionale. Të dy komponentët duhet të trajtohen pavarësisht 102 vendeve të reja, por me instrumente të ndryshme. Nëse vakancat ose mungesat e strukturës ekzistuese përfshihen brenda 84 vendeve operacionale apo 18 vendeve të rezervës pa kriterin përkatës, organika do të rritet në letër, por kapaciteti real nuk do të arrijë nivelin e synuar. Vendimi duhet të ketë tri pasqyra të veçanta, planin për hendekun 108, planin për 84 vendet e reja operacionale dhe regjistrin e 18 vendeve të rezervës.

Edhe brenda hendekut 108 duhet bërë ndarje. Një pjesë janë vende të pambushura në organikë. Një pjesë tjetër mund të lidhet me diferencën ndërmjet personave në organikën faktike dhe FTE-së reale, për shkak të mungesave, delegimeve, drejtimit, trajnimit afatgjatë ose angazhimeve të tjera. Vetëm pas këtij rakordimi mund të përcaktohet numri real i emërimeve që nevojitet dhe koha kur çdo emërim prodhon kapacitet në gjykatë.

Regjistri i personelit duhet të përdorë një identifikues unik për çdo gjyqtar dhe një gjendje të vetme kryesore për çdo periudhë, në detyrë në gjykatë, i deleguar, i angazhuar në institucion tjetër, në mungesë afatgjatë ose vend vakant. Një gjyqtar i deleguar nuk duhet të numërohet si 1 FTE në gjykatën e origjinës dhe 1 FTE në gjykatën pritëse. Totali kombëtar i FTE-ve duhet të jetë i barabartë me shumën e kohës reale të disponueshme, jo me shumën e listave të personelit të gjykatave.

Plani i plotësimit duhet të dallojë rekrutimin në shkallën e parë nga ngritja në detyrë në apel dhe Gjykatën e Lartë. Ngritja në detyrë plotëson një vend në nivelin më të lartë, por krijon një vakancë në gjykatën nga vjen gjyqtari. Prandaj çdo procedurë duhet të shoqërohet me analizën e efektit zinxhir. Numri i diplomuarve nga Shkolla e Magjistraturës, kohëzgjatja e procedurave dhe largimet e pritshme duhet të përfshihen në një plan shumëvjeçar të hyrjeve dhe daljeve.

KLGJ duhet të marrë raport tremujor për plotësimin e vakancave dhe raport vjetor për FTE-në. Objektivi nuk duhet të matet vetëm me numrin e emërimeve, por me rritjen e gjyqtarëve efektivisht në detyrë në gjykatat prioritare. Kjo është mënyra për të verifikuar nëse vendimi po prodhon kapacitet real.

10.4 Kapaciteti i përkohshëm prej 9 gjyqtarësh në Gjykatën e Lartë

Propozimi për 9 gjyqtarë në Gjykatën e Lartë ka karakter të jashtëzakonshëm dhe të përkohshëm. Ai nuk ndryshon rekomandimin për plotësimin e 19 vendeve të strukturës së zakonshme. Qëllimi është krijimi i kapacitetit shtesë për një portofol të përcaktuar të stokut, në mënyrë që ritmi i uljes së çështjeve të vjetra të rritet pa cenuar trajtimin e rekursit të ri dhe funksionin unifikues të gjykatës.

Mandati duhet të jetë një i vetëm dhe i parinovueshëm. Akti normativ duhet të përcaktojë kohëzgjatjen, kriteret e përzgjedhjes, organin kompetent, procedurën, garancitë e pavarësisë, papajtueshmëritë, shpërndarjen në kolegje dhe përfundimin automatik. Objektivat duhet të lidhen me numrin dhe moshën e çështjeve, jo vetëm me totalin e vendimeve. Raportimi tremujor duhet të tregojë çështjet e përfunduara, CR, DT dhe ndryshimin e stokut mbi tre dhe pesë vjet.

Para zbatimit kërkohet opinion juridik i posaçëm. Opinioni duhet të shqyrtojë përbërjen e Gjykatës së Lartë, mandatin e anëtarit, mënyrën e emërimit, statusin dhe efektin e një mandati të kufizuar. Nëse konkluzioni është se anëtarësia e përkohshme nuk lejohet pa ndryshim kushtetues ose ligjor, KLGJ duhet të paraqesë propozimin për ndërhyrje normative te organet kompetente ose të zgjedhë një mekanizëm tjetër të ligjshëm.

Mekanizmi alternativ duhet të ruajë objektivin e kapacitetit, por nuk mund të zëvendësojë gjyqtarin me personel administrativ për ushtrimin e funksionit gjykues. Ai mund të kombinojë forcimin e këshilltarëve ligjorë, organizimin e paneleve të dedikuara, përmirësimin e filtrimit procedural dhe mbështetjen teknike, vetëm në kufijtë që lejon ligji. Çdo alternativë duhet të ketë të njëjtin afat, objektiva dhe klauzolë përfundimi.

Personeli mbështetës i paketës 9 duhet të jetë po ashtu i përkohshëm ose i lidhur me kohëzgjatjen e mandatit. Përllogaritja orientuese jep 56 punonjës jogjyqtarë. Përfundimi i mandatit duhet të shoqërohet me plan për mbylljen, rishpërndarjen ose përfundimin e marrëdhënieve të këtyre pozicioneve sipas legjislacionit të punës dhe statusit të tyre.

10.5 Rishikimi vjetor dhe shpërndarja dinamike

Të 102 vendet janë të përhershme në organikë, por shpërndarja dhe ritmi i aktivizimit nuk duhet të mbeten të pandryshueshme nëse të dhënat ndryshojnë. Harta gjyqësore, fluksi, ndryshimet ligjore dhe plotësimi i vakancave mund të zhvendosin nevojën nga një gjykatë te tjetra. Për këtë arsye, KLGJ duhet të miratojë çdo vit një raport të kapaciteteve dhe, kur nevojitet, një akt rishpërndarjeje në përputhje me garancitë ligjore të statusit. Për rezervën funksionale kërkohet, përveç kësaj, verifikim nominal i shkakut.

Rishikimi duhet të përdorë të njëjtën metodologji çdo vit. Treguesit kryesorë janë: FTE-ja reale, hyrjet, çështjet e përfunduara, CR, DT, stoku sipas moshës, produktiviteti i peshuar dhe raporti i personelit mbështetës. Ndryshimi i numrit nuk duhet të bazohet në një tregues të vetëm. Për shembull, CR mbi 100 për qind mund të jetë rezultat i përfundimit të një grupi të madh çështjesh të thjeshta dhe duhet lexuar së bashku me stokun dhe kompleksitetin.

Raporti vjetor duhet të ndajë rezultatet e fluksit normal nga rezultatet e rikuperimit. Gjykata duhet të tregojë sa kapacitet përdoret për çështjet e reja dhe sa për stokun e vjetër. Kjo ndarje lejon vlerësimin nëse vendet e reja po parandalojnë krijimin e stokut të ri dhe njëkohësisht po ulin çështjet e vjetra. Pa këtë informacion, rritja e personelit mund të mos lidhet me rezultatin për të cilin është miratuar.

Rishpërndarja duhet të fillojë me pozicionet ende të paplotësuara dhe me rezervën funksionale. Lëvizja e gjyqtarëve në detyrë përdoret vetëm kur lejohet dhe duke respektuar statusin. Në këtë mënyrë, KLGJ mund të përshtatë kapacitetin pa krijuar pasiguri për gjyqtarët dhe pa pritur një rishikim të plotë të organikës kombëtare.

Në fund të vitit 2030 duhet të kryhet vlerësim i plotë. Ai duhet të përcaktojë nëse organika 519 mbetet e përshtatshme, nëse të 84 vendet operacionale janë aktivizuar me efekt të matshëm, nëse tavani 18 i rezervës duhet rishikuar dhe nëse masa 9 ka përfunduar me rezultatin e synuar. Vlerësimi duhet të mbështesë vendimin për periudhën pasardhëse dhe të publikohet në formë të përmbledhur për transparencë.

11. Administrata gjyqësore dhe personeli mbështetës

11.1 Parimi i kapacitetit të plotë

Gjyqtari nuk e përpunon i vetëm të gjithë ciklin e çështjes. Regjistrimi, njoftimet, administrimi i dosjes, përgatitja e seancës, mbajtja e procesverbalit, kërkimi juridik, anonimizimi, publikimi, arkivimi, statistikat dhe mbështetja teknike kryhen nga administrata gjyqësore. Nëse numri i gjyqtarëve rritet pa rritjen përkatëse të personelit, një pjesë e kohës së gjyqtarit zhvendoset te detyra që mund të kryhen nga administrata dhe produktiviteti i pritshëm nuk realizohet.

CEPEJ raporton për Shqipërinë në vitin 2024 një raport të përgjithshëm 3,3 punonjës jogjyqtarë për gjyqtar, i barabartë me medianën e Bashkimit Europian të raportuar në të njëjtin profil. Raporti ndryshon sipas nivelit, 2,9 në shkallën e parë, 4,3 në shkallën e dytë dhe 6,2 në Gjykatën e Lartë. Diferenca pasqyron nevojën më të lartë për kërkim juridik, administrim kolegjesh dhe funksione mbështetëse në nivelet më të larta.

Raporti Vjetor i KLGJ-së 2025 paraqet një kontroll tjetër ku raportin strukturor shqiptar 3,13 punonjës për gjyqtar dhe mesataren europiane 4,12. Këto vlera nuk janë identike me raportin faktik të profilit CEPEJ, sepse mund të përdorin baza, vite dhe përkufizime të ndryshme. Për këtë arsye, 4,12 përdoret si pikë konvergence dhe jo si koeficient që zëvendëson automatikisht raportet sipas nivelit.

Këto raporte nuk janë standard detyrues për çdo gjykatë. Ato përdoren si bazë e një skenari të plotë operacional. Numri konkret duhet të korrigjohet sipas nivelit të digjitalizimit, centralizimit të shërbimeve, numrit të sallave, orarit të seancave, volumit të njoftimeve dhe strukturës së çështjeve. Megjithatë, planifikimi pa asnjë raport do të nënvlerësonte koston reale të rritjes së organikës.

11.2 Llogaritja e shtesës së personelit jogjyqtar

Për 64 gjyqtarët e rinj në shkallën e parë përdoret raporti 2,9 dhe rezultojnë 185,6, të rrumbullakosur në 186 punonjës. Për 20 gjyqtarët e rinj në apel përdoret raporti 4,3 dhe rezultojnë 86 punonjës. Shtesa e përhershme e lidhur drejtpërdrejt me paketën 84 është, për rrjedhojë, 272 punonjës jogjyqtarë.

Për 18 vendet e rezervës funksionale përdoren të njëjtat raporte sipas nivelit. Dhjetë vendet e shkallës së parë kërkojnë 29 punonjës dhe tetë vendet e apelit kërkojnë 34,4, të rrumbullakosur në 35. Rezerva kërkon kështu 64 punonjës të përhershëm. Së bashku, 102 vendet e reja të gjyqtarëve kërkojnë 215 punonjës në shkallën e parë dhe 121 në apel, pra 336 punonjës jogjyqtarë të përhershëm.

Për 9 gjyqtarët e përkohshëm në Gjykatën e Lartë përdoret raporti 6,2 dhe rezultojnë 55,8, të rrumbullakosur në 56 punonjës. Kjo shtesë duhet të ketë të njëjtën kohëzgjatje me mekanizmin e përkohshëm ose një plan të miratuar për rishpërndarjen pas përfundimit. Në skenarin minimal, 102 vendet e përhershme dhe masa e përkohshme 9 kërkojnë gjithsej 392 punonjës jogjyqtarë shtesë në kulmin e zbatimit.

Komponenti	Niveli	Gjyqtarë shtesë	Raporti CEPEJ 2024	Personel jogjyqtar
84 vende operacionale	Shkalla e parë	64	2,9	186
84 vende operacionale	Apeli	20	4,3	86
18 vende rezervë	Shkalla e parë	10	2,9	29
18 vende rezervë	Apeli	8	4,3	35
TOTALI I PËRHERSHËM	Shkalla e parë + apel	102	Sipas nivelit	336
Gjykata e Lartë, një mandat	Gjykata e Lartë	9	6,2	56
TOTALI GJATË MANDATIT	**Të gjitha nivelet**	**111**	**Sipas nivelit**	**392**

Si kontroll konvergence, 102 vende të përhershme të shumëzuara me 4,12 japin 420,24, të rrumbullakosura lart në 421 punonjës. Duke ruajtur 56 punonjësit e paketës së përkohshme të Gjykatës së Lartë, tavani orientues gjatë mandatit do të ishte 477. Diferenca ndërmjet minimumit 336 dhe kontrollit 421 është 85 pozicione. Ajo nuk duhet miratuar si bllok i padiferencuar; duhet të aktivizohet vetëm kur analiza e proceseve dhe organika e gjykatës provojnë se shërbimet e centralizuara, teknologjia dhe personeli ekzistues nuk e mbulojnë nevojën.

Skenari i administratës	Baza	102 vende të përhershme	Paketa 9	Totali në kulm
Minimumi operacional	Raportet 2,9 / 4,3 / 6,2 sipas nivelit	336	56	392
Kontrolli i konvergjencës	4,12 për vendet e përhershme; 6,2 për GJL	421	56	477

12. Plani i zbatimit dhe ndikimi buxhetor

Zbatimi duhet të organizohet në faza, në mënyrë që emërimi i gjyqtarëve, rekrutimi i administratës, infrastruktura dhe buxheti të ecin së bashku. Miratimi i menjëhershëm i të gjithë numrit krijon tavanin institucional, por aktivizimi vjetor duhet të lidhet me burimin e kandidatëve dhe gatishmërinë e gjykatës pritëse.

Faza	Afati	Veprimi kryesor	Rezultati i pritshëm
Rakordimi	Brenda 3 muajve	Regjistri nominal i FTE-ve, vakancave, mungesave funksionale dhe personelit jogjyqtar	Bazë e vetme për aneksin sipas gjykatave
Miratimi strukturor	2027	Miratimi i 84 vendeve operacionale, 18 vendeve rezervë dhe minimumit 336 vende mbështetëse	Organikë kombëtare 519 dhe paketë mbështetëse
Aktivizimi i parë	2027–2028	Plotësimi i gjykatave me CR nën 100 dhe stok të vjetër	Ndalim i rritjes së stokut në gjykatat prioritare
Aktivizimi i dytë	2029–2030	Plotësimi i pjesës së mbetur dhe korrigjimi sipas monitorimit	Zbatim i kontrolluar i paketës 102
Mandati i posaçëm	Një mandat	Aktivizimi i 9 gjyqtarëve dhe 56 punonjësve pas kontrollit juridik	Kapacitet maksimal 528 dhe ulje e portofolit të përcaktuar
Vlerësimi përfundimtar	Fundi i vitit 2030	Vlerësimi i numrit, shpërndarjes dhe rezultateve	Propozim për periudhën pas vitit 2030

12.1 Elementet e kostos

Ky relacion përcakton numrin e vendeve, por nuk llogarit një shumë monetare, sepse materialet nuk përmbajnë pagat sipas kategorive, kontributet, kostot e hapësirave dhe pajisjeve. Përllogaritja buxhetore duhet të bëhet me të dhënat zyrtare të vitit të zbatimit.

Komponenti	Sasia bazë	Lloji i kostos	Mënyra e llogaritjes
Gjyqtarë operacionalë të përhershëm	84	Vjetore e përsëritshme	Pagë dhe kontribute sipas nivelit dhe vjetërsisë
Gjyqtarë të rezervës funksionale	18	Vjetore e përsëritshme	Pagë dhe kontribute sipas nivelit të aktivizimit
Personel jogjyqtar i përhershëm	336 minimum; deri 421 pas analizës	Vjetore e përsëritshme	Pagë dhe kontribute sipas kategorisë së pozicionit
Gjyqtarë për një mandat	9	E kufizuar në kohë	Pagë dhe kontribute për kohëzgjatjen e mandatit
Personel jogjyqtar për një mandat	56	E kufizuar në kohë	Pagë dhe kontribute për kohëzgjatjen ose tranzicionin
Hapësira dhe mobilimi	Sipas gjykatës	Kryesisht një herë	Vend pune, sallë, arkivë dhe kushte sigurie
Teknologjia	Sipas përdoruesit dhe gjykatës	Një herë dhe vjetore	Pajisje, licenca, lidhje, siguri dhe mirëmbajtje
Trajnimi	Sipas valëve të emërimit	Vjetore	Trajnim fillestar dhe vazhdues për gjyqtarë dhe administratë

13. Monitorimi dhe rishikimi vjetor

Monitorimi duhet të përgjigjet nëse vendet e reja kanë rritur kapacitetin real dhe kanë përmirësuar kohën e trajtimit. Raporti nuk duhet të kufizohet te numri i emërimeve. Ai duhet të tregojë FTE-në e shtuar, ndryshimin e fluksit, produktivitetin, stokun dhe kontributin e personelit mbështetës. Të dhënat raportohen sipas gjykatës, seksionit dhe llojit të çështjes, me agregim kombëtar për vendimmarrjen e KLGJ-së.

Treguesi	Përkufizimi	Objektivi gjatë rikuperimit	Frekuenca
FTE reale	Koha e plotë efektive në funksion gjykues	Rritje sipas planit të aktivizimit	Tremujore
Clearance Rate	Të përfunduara ndaj hyrjeve	Mbi 100 për qind në gjykatat me stok	Tremujore dhe vjetore
Disposition Time	Stoku ndaj të përfunduarave shumëzuar me 365	Ulje vjetore e qëndrueshme	Vjetore
Stoku mbi 3 vjet	Çështje të papërfunduara mbi tre vjet	Ulje e matshme çdo vit	Tremujore
Stoku mbi 5 vjet	Çështje të papërfunduara mbi pesë vjet	Trajtim me përparësi dhe ulje e përshpejtuar	Tremujore
Produktiviteti i peshuar	Rezultati i korrigjuar për kompleksitetin	Stabilitet ose rritje pa cenuar cilësinë	Vjetore
Personeli për gjyqtar	FTE jogjyqtarë ndaj FTE gjyqtarësh	Afrim me raportin e planifikuar sipas nivelit	Vjetore

Raporti vjetor duhet të propozojë masa korrigjuese. Nëse një gjykatë ka CR nën 100 % megjithëse vendet janë plotësuar, duhet të analizohet procesi i punës, përbërja e stokut dhe personeli mbështetës. Nëse një gjykatë ka kapacitet të pashfrytëzuar dhe fluks të qëndrueshëm, fillimisht rishikohen vendet operacionale ende të paaktivizuara. Rezerva funksionale mund të lëvizë vetëm duke ndjekur një mungesë funksionale të dokumentuar. Kjo e lidh organikën me rezultatet dhe mbron arsyen juridike të secilit komponent.

14. Rreziqet dhe masat kontrolluese

Rreziku	Pasojë e mundshme	Masa kontrolluese
Numërimi i stokut total si backlog	Mbivlerësim i kapacitetit të rikuperimit	Ndarja e stokut sipas afatit standard dhe moshës
Numërimi i dyfishtë i vakancave dhe mungesave funksionale	Rritje e pambështetur e paketës	Regjistër nominal dhe një shkak aktivizimi për çdo vend
Rritja pa burim rekrutimi	Vende formale pa gjyqtarë efektivë	Plan shumëvjeçar me Shkollën e Magjistraturës dhe procedurat e karrierës
Rritja pa administratë	Gjyqtarët kryejnë detyra mbështetëse dhe produktiviteti bie	Aktivizim paralel i minimumit 336 dhe 56 vendeve jogjyqësore; analizë deri në 421
Përdorimi i çështjeve pa peshim	Shpërndarje e padrejtë për gjykatat me çështje komplekse	Model pilot i peshimit dhe matje e kohës së punës
Mungesa e hapësirave dhe teknologjisë	Pozicione që nuk mund të ushtrojnë detyrën	Vlerësim infrastrukture para çdo vale aktivizimi
Papajtueshmëria e paketës 9 me kuadrin ligjor	Cenim i sigurisë juridike dhe statusit	Opinion kushtetues dhe ligjor para aktivizimit
Vazhdimi automatik i mandatit të posaçëm	Kthim i masës së përkohshme në strukturë të përhershme	Mandat i vetëm dhe klauzolë automatike përfundimi
Fokus vetëm te sasia	Rrezik për cilësinë dhe arsyetimin e vendimeve	Monitorim i prishjeve kthimeve dhe treguesve të cilësisë

Rreziku kryesor i kësaj politike është që numrat të miratohen pa krijuar kushtet e zbatimit. Për këtë arsye, vendimi duhet të lidhë aktivizimin e çdo grupi vendesh me katër kushte, kandidatët, personelin mbështetës, buxhetin dhe infrastrukturën. Mungesa e njërit prej këtyre elementeve duhet të raportohet si pengesë zbatimi dhe jo të fshihet pas numrit të vendeve të miratuara.

15. Infrastruktura gjyqësore si kusht për zbatimin efektiv të shtimit të numrit të gjyqtarëve

Shtimi i propozuar i numrit të gjyqtarëve nuk mund të trajtohet vetëm si një ndryshim formal i organikës së gjykatave. Krijimi i 102 pozicioneve shtesë në gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit, si dhe parashikimi i përkohshëm i 9 gjyqtarëve shtesë në Gjykatën e Lartë, duhet të shoqërohen domosdoshmërisht me vlerësimin dhe forcimin e kapaciteteve infrastrukturore të sistemit gjyqësor. Në kushtet aktuale, një pjesë e gjykatave përballen me mungesë të hapësirave të përshtatshme për zyra, salla gjykimi, sekretari, arkiva, ambiente për publikun dhe infrastrukturë të mjaftueshme teknologjike. Për rrjedhojë, nuk mund të pretendohet se vetëm shtimi numerik i gjyqtarëve do të sjellë automatikisht rritjen e eficiencës, uljen e stokut dhe përmirësimin e kohëzgjatjes së gjykimeve.

Çdo pozicion i ri gjyqtari kërkon një mjedis të plotë funksional pune. Kjo përfshin zyrën dhe pajisjet individuale, aksesin në sallat e gjykimit, pajisjet e regjistrimit audio, sistemet e menaxhimit të çështjeve, aksesin në bazat ligjore dhe shërbimet elektronike, mbështetjen nga sekretaria gjyqësore, administrata, shërbimi i teknologjisë së informacionit, arkiva, siguria dhe shërbimet e mirëmbajtjes. Në mungesë të këtyre elementeve, pozicioni i krijuar në organikë nuk përkthehet në një kapacitet real dhe të plotë pune. Përkundrazi, vendosja e një numri më të madh gjyqtarësh në të njëjtat ambiente dhe me të njëjtat burime të kufizuara mund të krijojë mbingarkesë të mëtejshme administrative dhe infrastrukturore.

Kufizimi i numrit të sallave të gjykimit është një nga çështjet që duhet të marrë vëmendje të veçantë. Nëse numri i gjyqtarëve rritet, por numri dhe disponueshmëria e sallave mbeten të pandryshuara, gjyqtarët nuk do të mund të zhvillojnë seancat sipas ritmit të kërkuar. Kjo mund të sjellë përplasje të kalendarëve gjyqësorë, shtyrje seancash dhe mosrealizim të kapacitetit të pritshëm të gjykimit. Në këtë mënyrë, një pjesë e përfitimit që synohet nga shtimi i organikës do të humbiste për shkak të një pengese thjesht infrastrukturore.

E njëjta rëndësi duhet t'i kushtohet infrastrukturës teknologjike. Shtimi i gjyqtarëve dhe i administratës mbështetëse rrit numrin e përdoruesve të sistemeve elektronike, kërkesat për pajisje kompjuterike, kapacitetin e rrjetit, ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave, licencat, sigurinë kibernetike dhe mbështetjen teknike. Për këtë arsye, zbatimi i organikës së re duhet të harmonizohet me zhvillimin e sistemit të ri të menaxhimit të çështjeve gjyqësore, me garantimin e pajisjeve për çdo përdorues dhe me sigurimin e kapaciteteve të nevojshme të rrjetit dhe të serverëve. Infrastruktura teknologjike duhet të planifikohet mbi bazën e numrit të ri të përdoruesve dhe jo vetëm mbi organikën ekzistuese.

Shtimi i numrit të gjyqtarëve kërkon gjithashtu rritje proporcionale të administratës gjyqësore dhe të personelit ndihmës. Një gjyqtar i ri nuk mund të prodhojë rezultatet e pritshme nëse nuk mbështetet nga sekretarë gjyqësorë, nëpunës të shërbimeve gjyqësore, ndihmës ligjorë, punonjës të arkivit, specialistë të teknologjisë së informacionit dhe personel sigurie. Mungesa e kësaj mbështetjeje do të zhvendoste një pjesë të detyrave administrative te vetë gjyqtari dhe do të reduktonte kohën që ai duhet t'i kushtojë shqyrtimit dhe arsyetimit të çështjeve. Për këtë arsye, kostimi i reformës duhet të përfshijë jo vetëm pagat e gjyqtarëve, por edhe pagat e administratës shtesë, pajisjet, mobilimin, licencat, mirëmbajtjen dhe shpenzimet operative.

Përpara shpërndarjes përfundimtare të pozicioneve shtesë, duhet të kryhet një vlerësim i posaçëm i gatishmërisë infrastrukturore për çdo gjykatë. Ky vlerësim duhet të evidentojë të paktën:

- numrin e zyrave dhe vendeve të punës që mund të vihen në dispozicion;
- numrin dhe shkallën e përdorimit të sallave të gjykimit;
- kapacitetet e sekretarisë dhe të arkivit;
- pajisjet kompjuterike dhe kapacitetet e rrjetit;
- kushtet e sigurisë fizike dhe teknike;
- ambientet për publikun, avokatët, prokurorët dhe personat e privuar nga liria;
- mundësinë e shtimit të administratës dhe personelit mbështetës;
- nevojën për rikonstruksion, zgjerim, marrje me qira ose ndërtim të ambienteve të reja.

Në përfundim të këtij vlerësimi, gjykatat mund të klasifikohen sipas nivelit të gatishmërisë: gjykata ku pozicionet e reja mund të aktivizohen menjëherë; gjykata ku aktivizimi kërkon ndërhyrje të kufizuara dhe afatshkurtra; dhe gjykata ku shtimi i plotë i organikës kërkon investime të konsiderueshme ose zgjidhje të reja godinash. Kjo do të mundësonte zbatimin me faza të vendimit, pa cenuar objektivin përfundimtar të rritjes së numrit të gjyqtarëve.

Për rrjedhojë, vendimi për miratimin e numrit të ri të gjyqtarëve duhet të shoqërohet me një plan të posaçëm infrastrukture, buxheti dhe burimesh njerëzore. Ky plan duhet të përcaktojë për çdo gjykatë ndërhyrjet e nevojshme, koston e pritshme, burimin e financimit, afatin e realizimit dhe strukturën përgjegjëse për zbatimin. Shtimi i organikës mund të miratohet si objektiv i nevojshëm institucional, por plotësimi dhe aktivizimi i pozicioneve duhet të koordinohen me krijimin e kushteve reale për ushtrimin e funksionit.

Në këtë kuptim, duhet të theksohet qartë se infrastruktura nuk përbën një element dytësor të reformës, por një parakusht për suksesin e saj. Pa zyra, salla gjykimi, administratë mbështetëse, pajisje teknologjike dhe kushte të përshtatshme sigurie, shtimi i numrit të gjyqtarëve do të mbetej kryesisht një shtim formal në organikë dhe nuk do të prodhonte plotësisht efektin e synuar në uljen e stokut, përshpejtimin e gjykimeve dhe përmirësimin e aksesit të qytetarëve në drejtësi.

15. Përfundimet

Të dhënat dhe vlerësimi institucional mbështesin miratimin e 84 vendeve operacionale të përhershme në shkallën e parë dhe apel. Ato ndahen në 64 vende në shkallën e parë dhe 20 në apel, me shpërndarjen fillestare sipas juridiksioneve dhe gjykatave të paraqitur në këtë relacion. Mbi këtë paketë propozohen 18 vende të përhershme të rezervës funksionale, 10 në shkallën e parë dhe 8 në apel. Shtesa e përhershme është kështu 102 vende dhe organika kombëtare rritet nga 417 në 519 gjyqtarë, ose 22,2 gjyqtarë për 100 000 banorë.

Brenda 44 vendeve të juridiksionit të përgjithshëm të shkallës së parë, rivlerësimi përfundimtar është: 18 Tiranë dhe 26 jashtë Tiranës, të ndara në Durrës 6, Elbasan 5, Fier 6, Korçë 3, Shkodër 3 dhe Vlorë 3. Berati, Dibra, Gjirokastra, Kukësi, Lezha dhe Saranda ruajnë organikën aktuale pa shtesë në fazën e parë. Kjo ndarje bazohet në ngarkesën e vitit 2025 dhe në rezultat të ponderuar me stokun, CR-në e DT-në; ajo duhet të rishikohet çdo vit pa ulur automatikisht organikën e gjykatave të vogla.

Veçmas, analiza mbështet nevojën funksionale për 9 gjyqtarë shtesë në Gjykatën e Lartë për një mandat të vetëm. Me këtë masë, tavani gjatë mandatit arrin 528 gjyqtarë ose 22,6 për 100 000 banorë. Aktivizimi duhet të kushtëzohet nga vlerësimi kushtetues dhe ligjor dhe nga krijimi i bazës normative. Miratimi i nevojës nuk duhet të interpretohet si autorizim i drejtpërdrejtë për emërim jashtë procedurave të parashikuara nga ligji.

Paketa e gjyqtarëve duhet të shoqërohet së paku me 336 punonjës jogjyqtarë të përhershëm dhe 56 punonjës të lidhur me mandatin e përkohshëm, pra 392 në skenarin minimal gjatë kulmit. Kontrolli i konvergjencës jep 421 vende të përhershme dhe 477 gjithsej gjatë mandatit. Ndarja orientuese sipas kategorive në këtë relacion bazohet në minimumin 336; çdo rritje drejt 421 duhet të dalë nga analiza e vendeve të punës, jo nga shumëzimi mekanik. KLGJ duhet të miratojë minimumin, t'i ngarkojë strukturat përgjegjëse të përgatisin organikën e detajuar dhe të paraqesin, kur provohet nevoja, fazën shtesë deri në tavanin e konvergjencës.

15.1 Formulimi i rekomanduar i pikave të vendimit

1. Të miratohet rritja operacionale e numrit të gjyqtarëve në gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit me 84 vende të përhershme, duke e çuar organikën kombëtare nga 417 në 501 gjyqtarë përpara rezervës funksionale.

2. Të miratohet ndarja e 84 vendeve operacionale me 64 vende në shkallën e parë dhe 20 vende në apel, sipas shpërndarjes fillestare në aneks dhe me aktivizim shumëvjeçar.

3. Të miratohet, brenda 44 vendeve të juridiksionit të përgjithshëm të shkallës së parë, ndarja 18 vende për Tiranën dhe 26 vende jashtë Tiranës: Durrës 6, Elbasan 5, Fier 6, Korçë 3, Shkodër 3 dhe Vlorë 3.

4. Të miratohen, veçmas dhe mbi 84 vendet operacionale, 18 vende të përhershme të rezervës funksionale, 10 për shkallën e parë dhe 8 për apelin, duke e çuar organikën kombëtare në 519 gjyqtarë.

5. Të kushtëzohet aktivizimi i çdo vendi të rezervës me regjistrin nominal të FTE-së së humbur, bazën ligjore, kohëzgjatjen dhe gjykatën e origjinës, me rishikim të paktën vjetor.

6. Të miratohet një plan i veçantë për mbylljen e hendekut efektiv 108, me dy nënregjistra: 74 vende të pazëna dhe 34 FTE të humbjes funksionale neto, pa i përfshirë këto në 102 vendet e reja.

7. Të miratohet nevoja e vlerësuar për një kapacitet shtesë prej 9 gjyqtarësh në Gjykatën e Lartë për një mandat të vetëm dhe të ngarkohet administrata për përgatitjen e analizës kushtetuese dhe ligjore dhe të propozimit normativ.

8. Të miratohet si minimum planifikimi shtesa prej 336 punonjësish jogjyqtarë për 102 vendet e përhershme dhe 56 punonjësish për paketën e përkohshme; të përgatitet analiza e vendeve të punës për një tavan konvergence deri në 421 pozicione të përhershme.

9. Të ngarkohen strukturat përgjegjëse për përfshirjen e kostove në programin buxhetor afatmesëm dhe për sigurimin e hapësirave, pajisjeve, teknologjisë dhe trajnimit.

10. Të miratohet monitorimi vjetor sipas FTE-së reale, hyrjeve, çështjeve të përfunduara, CR-së, DT-së, stokut sipas moshës, produktivitetit të peshuar dhe raportit të personelit mbështetës.

11. Të kryhet në fund të vitit 2030 vlerësimi i plotë i rezultateve dhe të paraqitet propozimi për organikën e periudhës pasardhëse.

Shtojca 1. Kontrolli i llogaritjeve për shkallën e parë

Grupi	Hyrjet mesatare	Të përfunduara mesatare	Stoku 2025	Skenari 1 produktivitet faktik	Skenari 1 KLGJ	Skenari 2 KLGJ
Juridiksioni i përgjithshëm	83 648	83 640	39 767	153,7	209,1	229,0
Administrative	14 343	13 862	8 796	22,8	41,0	46,0
TOTALI	**97 991**	**97 502**	**48 563**	**176,5**	**250,1**	**275,0**

Vlerat me presje janë FTE teorike. Në rekomandimin sipas gjykatave rezultatet rrumbullakosen lart dhe organika ekzistuese ruhet si dysheme. Për këtë arsye, shuma e rekomandimeve të rrumbullakosura nuk është në çdo rast e barabartë me totalin decimal të modelit.

Shtojca 2. Kontrolli aritmetik i paketës përfundimtare

Niveli	Struktura aktuale	84 vende operacionale	18 vende rezervë	Struktura e përhershme	9 vende të përkohshme	Tavani gjatë mandatit
Shkalla e parë	287	64	10	361	—	361
Apeli	111	20	8	139	—	139
Gjykata e Lartë	19	0	0	19	9	28
TOTALI	**417**	**84**	**18**	**519**	**9**	**528**

Kontrolli është: 417 + 84 + 18 = 519 vende të përhershme. Masa e Gjykatës së Lartë llogaritet veçmas: 519 + 9 = 528 gjatë një mandati. Krahasuar me 309 gjyqtarët efektivë, plotësimi i të gjithë kapacitetit të përhershëm do të kërkonte 210 gjyqtarë më shumë në detyrë, ndërsa gjatë mandatit të posaçëm diferenca do të ishte 219. Këto diferenca përfshijnë si plotësimin e boshllëkut ekzistues, ashtu edhe vendet e reja; ato nuk janë të gjitha vende të reja të organikës.

Kontrolli demografik është: 519 / 2 335 930 × 100 000 = 22,2 gjyqtarë për 100 000 banorë; 528 / 2 335 930 × 100 000 = 22,6. Për krahasim, 84 vendet operacionale pa rezervën japin 501 / 2 335 930 × 100 000 = 21,4. Këto raporte publikohen së bashku me FTE-në reale, në mënyrë që organika formale të mos ngatërrohet me kapacitetin faktik të gjykimit.

Shtojca 3. Gjendja e personelit më 24.09.2026

Niveli / juridiksioni	Struktura	Në fakt	Efektivisht	Hendeku permanent	Mungesa funksionale neto	Hendeku efektiv
Gjykata e Lartë	19	17	15	2	2	4
Apeli i juridiksionit të përgjithshëm	78	37	41	41	-4	37
Apeli i posaçëm	11	10	10	1	0	1
Shkalla e parë e juridiksionit të përgjithshëm	235	216	180	19	36	55
Shkalla e parë e posaçme	16	13	15	3	-2	1
Apeli administrativ	22	14	18	8	-4	4

Niveli / juridiksioni	Struktura	Në fakt	Efektivisht	Hendeku permanent	Mungesa funksionale neto	Hendeku efektiv
Shkalla e parë administrative	36	36	30	0	6	6
TOTALI	**417**	**343**	**309**	**74**	**34**	**108**

Hendeku permanent është Struktura minus Në fakt; mungesa funksionale neto është Në fakt minus Efektivisht; hendeku efektiv është Struktura minus Efektivisht. Vlera negative në kolonën e mungesës funksionale neto tregon përforcim të kategorisë me delegim ose caktim nga një burim tjetër, jo kapacitet shtesë të përhershëm. Kolona e fundit rakordon saktësisht me materialin e datës 24.09.2026.

Shtojca 4. Matrica e rivlerësimit jashtë Tiranës

Gjykata	Kërkesa e rikuperimit	Pesha e kërkesës	Pesha e stokut	Risku DT	Deficiti CR	Rezultati	Kuota	Shtesa
Durrës	8 420,2	22,35%	26,14%	22,01%	14,81%	22,74%	5,913	6
Elbasan	5 444,6	14,45%	24,49%	51,70%	0,00%	18,65%	4,849	5
Fier	9 057,4	24,04%	16,48%	9,68%	51,85%	22,32%	5,802	6
Korçë	5 274,2	14,00%	13,32%	15,86%	33,33%	14,43%	3,753	3
Shkodër	4 703,2	12,49%	9,06%	0,76%	0,00%	10,78%	2,804	3
Vlorë	4 769,8	12,66%	10,51%	0,00%	0,00%	11,07%	2,879	3
TOTALI	**37 669,4**	**100,00%**	**100,00%**	**100,00%**	**100,00%**	**100,00%**	**26,000**	**26**

Formula e rezultatit është: 0,75 × pesha e kërkesës së rikuperimit + 0,15 × pesha e stokut + 0,08 × pesha e riskut DT + 0,02 × pesha e deficitit CR. Kërkesa e rikuperimit është hyrjet 2025 + stoku në fund / 5. Risku DT mat tejkalimin relativ të mesatareve 270 ditë civile dhe 92 ditë penale. Deficiti CR mat vetëm pjesën nën 100 për qind. Aneksi Excel përmban formulat qelizë për qelizë dhe lejon ndryshimin e kontrolluar të peshave, pragut dhe periudhës së rikuperimit.

Shtojca 5. Fjalori i treguesve

Termi	Kuptimi në këtë relacion
Organika e miratuar	Numri i vendeve të autorizuara me aktin përkatës
Organika në fakt	Numri i personave që mbajnë pozicione në strukturë në datën e raportimit
Efektivisht në detyrë	Numri i gjyqtarëve faktikisht të disponueshëm sipas pasqyrës së personelit
FTE reale	Ekuivalenti me kohë të plotë i kapacitetit real të ushtrimit të funksionit gjykues gjatë periudhës
Stok	Të gjitha çështjet e papërfunduara në një datë të caktuar
Backlog	Pjesa e stokut që ka kaluar afatin ose objektivin kohor të përcaktuar
Clearance Rate	Raporti ndërmjet çështjeve të përfunduara dhe çështjeve të ardhura
Disposition Time	Vlerësimi teorik i ditëve për përpunimin e stokut me ritmin aktual
Rezervë funksionale	Vende të përhershme që kompensojnë kapacitetin e humbur nga angazhimet institucionale afatgjata

Shtojca 6. Burimet kombëtare të përdorura

- Nr Gjyqtarëve.docx
- INFORMACION për metodologjinë e nr. te gjyqtarëve.docx
- Mbi metodologjinë orientuese për rishikimin e numrit të gjyqtarëve në sistemin gjyqësor shqiptar.docx
- INFORMACION për metodologjinë e nr. te gjyqtarëve(1).docx
- Të dhënat për çështjet 2021-2025(1).xlsx
- magjistrate, ndihmesa-ligjor 2021-2026(1).xlsx
- Numri i Gjyqtareve_JP_Shkalla e pare_FIN (1).xlsx
- Numri i Gjyqtareve_Gjykata administrative_FIN (1).xlsx
- Për pasqyrim - Gj. Sh. I J.P, Gj. Adm. Sh. I.xlsx
- shpjegime.docx
- Informacion, date 24.09.2026 (1).xlsx

Shtojca 7. Burimet zyrtare të jashtme

1. KLGJ Raporti Vjetor 2025. Burimi zyrtar
2. INSTAT Popullsia e Shqipërisë më 1 janar 2026. Burimi zyrtar
3. CEPEJ European judicial systems Evaluation Report 2024 2022 data Part 1. Burimi zyrtar
4. CEPEJ Dashboard Western Balkans II Albania profile 2024 data. Burimi zyrtar
5. CEPEJ Backlog reduction tool. Burimi zyrtar
6. CEPEJ Studies No 28 Case weighting in judicial systems. Burimi zyrtar
7. CEPEJ Study on workload measurement systems in courts 2025. Burimi zyrtar
8. KLGJ Vendim nr 433 datë 22 07 2025. Burimi zyrtar
9. Qendra e Botimeve Zyrtare legjislacioni i sistemit të drejtësisë. Burimi zyrtar

PËRMBLEDHJE

Ky relacion paraqet vlerësimin e nevojës për rishikimin e numrit të gjyqtarëve në sistemin gjyqësor shqiptar për periudhën 2026–2030. Analiza synon të përcaktojë kapacitetin e nevojshëm për përballimin e fluksit të çështjeve të reja, parandalimin e krijimit të stokut të mëtejshëm, uljen graduale të çështjeve të prapambetura dhe garantimin e funksionimit normal të gjykatave në të gjitha nivelet.

Studimi mbështetet në të dhënat kombëtare për personelin dhe ngarkesën gjyqësore gjatë viteve 2023–2025, Raportin Vjetor të KLGJ-së për vitin 2025, të dhënat e përditësuara të personelit deri më 24.09.2026, treguesit e CEPEJ-it, të dhënat demografike të INSTAT-it dhe standardet e miratuara nga KLGJ-ja për ngarkesën vjetore të gjyqtarëve. Metodologjia nuk mbështetet në një tregues të vetëm, por kombinon hyrjet e çështjeve, produktivitetin, stokun sipas vjetërsisë, FTE-në reale, Clearance Rate, Disposition Time, kompleksitetin e çështjeve dhe kërkesat minimale për formimin e trupave gjykues.

Analiza dallon qartë ndërmjet kapacitetit minimal që nevojitet për përballimin e fluksit normal të çështjeve dhe kapacitetit shtesë që kërkohet për reduktimin e stokut të akumuluar. Krahasimi me mesataren europiane të numrit të gjyqtarëve për 100 000 banorë përdoret si kontroll i arsyeshmërisë së rezultatit dhe jo si formulë mekanike për përcaktimin e organikës.

Gjendja e personelit më 24.09.2026 evidenton 417 vende të miratuara, 343 gjyqtarë në organikën faktike dhe 309 gjyqtarë efektivisht në detyrë. Diferenca prej 108 gjyqtarësh ndërmjet organikës së miratuar dhe kapacitetit efektiv përbëhet nga 74 vende të pazëna dhe 34 FTE të humbura për shkaqe funksionale. Ky hendek duhet të trajtohet me një plan të veçantë për plotësimin e vakancave dhe kompensimin e mungesave funksionale dhe nuk duhet të përfshihet ose të numërohet përsëri brenda 102 vendeve të reja të propozuara.

Përfundimi kryesor i studimit

Masa e propozuar	Numri
Vende të reja operacionale të përhershme	84
Rezervë funksionale e përhershme	18
Shtesa e përhershme gjithsej	**102**
Organika kombëtare pas shtesës	**519**
Kapacitet i përkohshëm në Gjykatën e Lartë	9
Kapaciteti maksimal gjatë mandatit të posaçëm	**528**
Personel jogjyqtar i përhershëm – minimumi	336
Personel jogjyqtar për paketën e përkohshme	56

Paketa kryesore përmban 84 vende të reja operacionale të përhershme, nga të cilat 64 propozohen për gjykatat e shkallës së parë dhe 20 për gjykatat e apelit. Brenda shkallës së parë, 44 vende i përkasin juridiksionit të përgjithshëm, 18 juridiksionit administrativ dhe 2 Gjykatës së Posaçme. Në nivel apeli

propozohen 6 vende për Apelin e Juridiksionit të Përgjithshëm, 12 për Apelin Administrativ dhe 2 për Apelin e Posaçëm.

Nga 44 vendet e juridiksionit të përgjithshëm të shkallës së parë, 18 propozohen për Gjykatën e Tiranës dhe 26 për gjykatat e tjera të mëdha: Durrës 6, Fier 6, Elbasan 5, Korçë 3, Shkodër 3 dhe Vlorë 3. Kjo shpërndarje reflekton jo vetëm numrin e çështjeve të regjistruara, por edhe stokun, kohën e pritshme të përpunimit, aftësinë për të përballuar hyrjet dhe rolin territorial të këtyre gjykatave. Gjykatat e tjera ruajnë organikën ekzistuese dhe përfitojnë në radhë të parë nga plotësimi i vakancave dhe nga mekanizmi i rezervës funksionale.

Mbi paketën operacionale prej 84 vendesh propozohet krijimi i 18 vendeve të përhershme të rezervës funksionale, të ndara fillimisht në 10 vende për shkallën e parë dhe 8 për apelin. Rezerva synon të kompensojë humbjen reale të kapacitetit kur gjyqtarë me status aktiv ushtrojnë funksione afatgjata si anëtarë të KLGJ-së, këshilltarë ligjorë në Gjykatën e Lartë, pranë ILD-së ose në institucione të tjera të sistemit të drejtësisë. Aktivizimi i çdo vendi duhet të mbështetet në regjistrin nominal të FTE-së së humbur, kohëzgjatjen e angazhimit dhe gjykatën e origjinës, në mënyrë që rezerva të mos shndërrohet në një shtesë të zakonshme dhe të pajustifikuar të organikës.

Me miratimin e 84 vendeve operacionale dhe 18 vendeve të rezervës funksionale, organika kombëtare rritet nga 417 në 519 gjyqtarë. Duke përdorur popullsinë prej 2 335 930 banorësh, ky nivel përfaqëson rreth 22,2 gjyqtarë për 100 000 banorë, shumë pranë mesatares europiane të CEPEJ-it prej rreth 22 gjyqtarësh për 100 000 banorë. Ky rezultat konfirmon arsyeshmërinë demografike të propozimit, por baza kryesore e vendimmarrjes mbetet ngarkesa konkrete e sistemit shqiptar.

Për Gjykatën e Lartë propozohet njohja e nevojës për një kapacitet shtesë prej 9 gjyqtarësh për një mandat të vetëm, të kufizuar dhe të parinovueshëm. Kjo masë duhet të lidhet me trajtimin e një portofoli të përcaktuar të çështjeve të vjetra dhe me objektiva të matshëm për uljen e stokut. Aktivizimi i saj kërkon paraprakisht vlerësim të posaçëm kushtetues dhe ligjor dhe krijimin e bazës së nevojshme normative. Miratimi i nevojës funksionale nga KLGJ-ja nuk mund të interpretohet si autorizim për emërimin e gjyqtarëve jashtë procedurave dhe garancive të parashikuara nga Kushtetuta dhe ligji.

Rritja e numrit të gjyqtarëve duhet të shoqërohet domosdoshmërisht me shtimin e administratës gjyqësore. Mbi bazën e raporteve faktike të CEPEJ-it sipas niveleve të gjykimit, 102 vendet e përhershme kërkojnë së paku 336 punonjës jogjyqtarë. Paketa e përkohshme prej 9 gjyqtarësh në Gjykatën e Lartë kërkon rreth 56 punonjës shtesë. Kontrolli i konvergjencës me mesataren europiane jep një tavan orientues prej 421 punonjësish të përhershëm, por kalimi nga minimumi 336 drejt këtij tavani duhet të mbështetet në analizën konkrete të vendeve të punës dhe jo në shumëzim mekanik.

Kushti infrastrukturor

Shtimi i propozuar nuk mund të realizojë objektivat e tij në kushtet e një infrastrukture të pamjaftueshme. Nuk mund të pretendohet se krijimi formal i vendeve të reja do të sjellë automatikisht rritje të eficiencës nëse gjykatat nuk disponojnë zyra, salla gjykimi, sekretari, arkiva, pajisje, sisteme teknologjike, kapacitete rrjeti, kushte sigurie dhe personel mbështetës të mjaftueshëm.

Çdo grup vendesh të reja duhet të aktivizohet vetëm pasi të jetë verifikuar gatishmëria e gjykatës pritëse. Vendimi duhet të shoqërohet me një plan të posaçëm infrastrukture dhe investimesh, ku të përcaktohen nevojat sipas gjykatave, kostot, burimet e financimit, afatet dhe strukturat përgjegjëse. Në të kundërt, shtimi do të mbetej një rritje formale e organikës dhe jo një rritje reale e kapacitetit gjykues.

Zbatimi rekomandohet të kryhet me faza gjatë periudhës 2027–2030 dhe të lidhet me katër kushte të pandashme: sigurimin e kandidatëve, personelin mbështetës, financimin buxhetor dhe gatishmërinë infrastrukturore. Përparësi duhet t'u jepet gjykatave me Clearance Rate nën 100%, stok të lartë dhe çështje me vjetërsi mbi tre dhe pesë vjet.

Në përfundim, studimi mbështet miratimin e 102 vendeve të reja të përhershme në shkallën e parë dhe apel, të përbëra nga 84 vende operacionale dhe 18 vende të rezervës funksionale, si dhe njohjen e nevojës për 9 gjyqtarë shtesë të përkohshëm në Gjykatën e Lartë. Ky propozim përbën një ndërhyrje të domosdoshme për stabilizimin afatgjatë të sistemit, por rezultatet e tij varen nga plotësimi paralel i vakancave ekzistuese, administrata mbështetëse, infrastruktura, financimi dhe monitorimi i vazhdueshëm i performancës.